



FAQE 14

AKTUALE

RINIA NË PDK, BARTËSE E PLATFORMËS SË DEKADËS SË RE F.3



Kryetari i Rinisë Demokratike të Kosovës (RDK), Donjet Bislimi, në një bisedë për gazetën "Epoka e re" ka theksuar se të rinjtë e të rejtat po e përqafojnë gjithandej Kosovës mesazhin dhe vizionin e platformës së Dekadës së Re

FUSHATA KUNDËR UÇK-së? F.11



Jakup KRASNIQI

GJERMANIA, 'SKEPTIKE' NDAJ IDESË PËR NDRYSHIMIN E KUFIJVE KOSOVË - SERBI F.2

DREJTORI I SHSKUK-SË: NUK DO TË LEJOJMË ANARKI F.6

EKONOMI

KUVENDI I KOSOVËS SHPENZOI 48 PËR QIND TË BUXHETIT NË PAGA DHE MËDITJE F.9

KULTURË

NDËRRON JETË RAPSODI HASHIM SHALA F.11

SPORT

SOKOLI - LLAPI, E ARDHMJA NË 'MJEGULL' F.18

50 MIJË EURO PËR STADIUMIN E HANIT TË ELEZIT F.18

FLET PËR "EPOKËN E RE", HAXHI SHALA | FAQE 4-5

Iniciativa për ushtri nuk duhet të kthehet mbrapa



Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haxhi Shala, ka vlerësuar se iniciativa për transformimin e FSK-së në ushtri përmes ligjit është bërë në kohën e duhur. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky veprim është bërë në koordinim me faktorin ndërkombëtar. Shala ka thënë se transformimi i FSK-së është domosdoshmëri e kohës dhe nuk po bëhet për poenë politike e elektoral. Ai ka theksuar se meqë FSK-ja aktualisht nuk mund të transformohet në ushtri me ndryshime kushtetuese, atëherë duhet t'i jepen kompetenca me anë të ligjit. Sipas Shalës, kjo iniciativë për ushtri duhet të miratohet sa më shpejt në Kuvendin e Kosovës dhe jo të kthehet mbrapa siç ka ndodhur në të kaluarën

PËRFAQËSUESIT E ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS SË
UÇK-SË KANË MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIA

OVLUÇK-ja kërkon rivlerësim të procesit të verifikimit të veteranëve të luftës



Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati, në një konferencë për media mbajtur të mërkurën ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta fillojë rivlerësimin e procesit të verifikimit të

veteranëve të luftës me anë të një komisioni i cili do të punojë në bazë të kriterëve të sakta të përcaktuara me Ligjin e veteranëve të luftës së UÇK-së. Ndërkaq, sipas tij, publikimi i listës me emra të veteranëve është shkelje e ligjit | FAQE 3



Sami Lushtaku: Sylejman Selimi nuk është i burgosur, por i kidnapuar

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Gjermania, "skeptike" ndaj idesë për ndryshimin e kufijve Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Ministrin i Jashtëm Federal i Gjermanisë, Heiko Maas, ka rikonfirmuar qëndrimin e shtetit të tij kundër idesë për korrigjimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke thënë se Berlina mbetet

skeptik ndaj një zgjidhjeje të tillë. "Në javët e shkuara kemi zhvilluar biseda të ndryshme dhe shpesh është thënë se ekziston frika e një efekti domino. Një frikë që e kemi perceptuar dhe që do të luajë rol. Ne

jemi skeptikë dhe diskretë në këtë pikë. Çështja duhet të zgjidhet në një mënyrë të tillë që të mos krijohen probleme të tjera shtesë, përveç atyre ekzistuese. Nëse korrigjimi i kufijve do të ofrohet si zgjidhje,

ne jemi skeptikë dhe të përmbytur", ka deklaruar ministri Maas gjatë vizitës në Tiranë, ku ka mbajtur një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama.



Policia e Kosovës, e Shqipërisë dhe e Italisë flasin për terrorizmin

Drejtori i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka thënë se terrorizmi si fenomen ka shtrirje mjaft të gjerë, duke tejkaluar edhe kufijtë kombëtarë dhe rajonalë, dhe se asnjë vend si i vetëm nuk mund të jetë i suksesshëm për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit



PRISHTINË, 19 SHTATOR - Drejtoria Kundër Terrorizmit e Policisë ishte nikoqire e takimit trepalësh ndërmjet drejtorive kundër terrorizmit të policisë italiane dhe policisë shqiptare. Ky takim vjen si rezultat i takimeve të mëherëshme të realizuara në Itali dhe në Shqipëri, në kuadër të vlerësimit të kërcënimeve aktuale dhe vazhdimit të bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të tri organizatave policore.

Drejtori i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka thënë se terrorizmi si fenomen ka shtrirje mjaft të gjerë, duke tejkaluar edhe kufijtë kombëtarë dhe rajonalë, se asnjë vend i vetëm nuk mund të jetë i suksesshëm për parandalimin

dhe luftimin e terrorizmit. "E vetmja mënyrë që garanton sukses në këtë aspekt është bashkëpunimi dhe shkëmbimi me kohë i informacioneve, andaj edhe ne si Polici e Kosovës e vlerësojmë shumë lart këtë iniciativë të bashkëpunimit trepalësh në mes të Policisë së Kosovës, Policisë italiane dhe Policisë shqiptare që, pa dyshim, është e rëndësishë së veçantë për sigurinë e të gjitha vendeve tona, por edhe kontribues në sigurinë rajonale dhe atë globale", ka thënë Qalaj.

Ai ka shtuar se bashkëpunimi në kuadër të këtij grupi, por edhe formave të tjera të bashkëpunimit, do ta ketë përkrahjen e plotë të Policisë së Kosovës si partnere e

rëndësishme për sigurinë rajonale dhe atë globale dhe do të hapë rrugë për rrugëtimin drejt anëtarësimit të plotë në mekanizma ndërkombëtarë të sigurisë. Ndër të tjera, Qalaj ka kërkuar mbështetjen dhe përkrahjen e

institucioneve përfaqësuese në përpjekjet për anëtarësim të PK-së në Interpol gjatë asamblesë së përgjithshme në nëntor të këtij viti.

Gjatë takimit të pranishmit u zotuan për bashkëpunim të

ndërsjellë dhe përkushtim drejt avancimit për shkëmbimin e informacioneve dhe për mbështetjen ndërmjet partnerëve, me interesa të përbashkëta për parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie.

Tahiri kërkon mbështetjen e homologes gjermane për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 19 SHTATOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, po qëndron në një vizitë zyrtare në Gjermani, me ftesë të ministres Federale të Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, Katarina Barley. Në takim dypalësh ministri Tahiri e ka njoftuar homologen gjermane për angazhimin për përmbyshjen e Agjendës së Reformave Evropiane, për reformat në drejtësinë penale, kodifikimin e të drejtës civile,



bashkëpunimin juridik ndërkombëtar si dhe për reformën strukturore të sektorit të

sundimit të ligjit. Tahiri ka shprehur konsideratën e lartë për kontributin që

Gjermania ka dhënë në gjithë procesin e shtetndërtimit të Kosovës si dhe për mbështetjen e dhënë për procesin e liberalizimit të vizave. Në këtë kuadër, ministri Tahiri ka kërkuar mbështetje edhe për fuqizimin e kapaciteteve të mjekësisë ligjore përmes akreditimit të programeve dhe trajnimit të punonjësve mjekoligjorë në fusha specifike si dhe për konsolidimin e drejtësisë komerciale përmes një programi të veçantë të trajnimit

për organet e sundimit të ligjit në çështjet që ndërlidhen me efikasitetin e shërbimeve gjyqësore ndaj sektorit të biznesit.

Ndërsa ministrja Federale e Drejtësisë së Gjermanisë, Katarina Barley, ka mirëpritur angazhimin institucional në fushën e sundimit të ligjit, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe ka shprehur mbështetjen e plotë të Gjermanisë për proceset e reformave të ndërmarra.

Haradinaj priti në takim drejtuesin e dialogut teknik, Cooperin

PRISHTINË, 19 SHTATOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të mërkurën në takim një delegacion nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie me Jashtë, i kryesuar nga Robert Cooper. Kryeministri Haradinaj ka vlerësuar angazhimin dhe punën e Robert Cooperit për dizajnimin

dhe udhëheqjen e dialogut teknik ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në kohën sa ishte i angazhuar në pozitën e larta të institucioneve të Bashkimit Evropian.

Haradinaj ka thënë se roli i Këshillit Evropian për Marrëdhënie me Jashtë është i rëndësishëm për gjetjen e zgjid-

hjeve më të mira për marrëveshjen përfundimtare për zgjidhjen e problemeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Po ashtu, kryeministri Haradinaj ka theksuar se Qeveria dhe institucionet e Republikës së Kosovës janë të përkushtuara për përmbyshjen e Reformave të Agjendës Evropiane. Haradinaj e ka njoftuar Robert

Cooperin për të gjitha të arriturat në vend, për projektet me rëndësi për zhvillimin ekonomik, për angazhimin për fuqizimin e rendit dhe ligjit, për fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të vendit, për anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare.

Ndërsa Robert Cooper e ka falënderuar kryeministrin Haradinaj



për pritjen dhe ka vlerësuar të arriturat në Kosovë, duke shprehur përkushtimin e tij për t'i ofruar Kosovës mbështetje në rrugën evropiane.

Përfaqësuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së kanë mbajtur konferencë për media

OVLUÇK-ja kërkon rivlerësim të procesit të verifikimit të veteranëve të luftës



Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati, në një konferencë për media të mërkurën ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që ta fillojë rivlerësimin e procesit të verifikimit të veteranëve të luftës me anë të një komisioni i cili do të punojë në bazë të kriterëve të sakta të përcaktuara me Ligjin e Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Ndërkaq, sipas tij, publikimi i listës me emra të veteranëve është shkelje e ligjit

cesi me anë të një komisioni i cili do të punojë në bazë të kriterëve të sakta të përcaktuara me Ligjin e Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Kjo gjë do të ishte më pak e kushtueshme dhe prokuroria do të lirohet në punën e saj", ka thënë Gucati.

Ai ka kërkuar që të gjithë ata veteranë të cilët janë në listat e publikuara të mos ndërmarrin asnjë masë. I pyetur nga gazetarët për numrin e veteranëve për të cilin prokuroria ka thënë se janë 80 mijë, Gucati e ka quajtur prokurorinë "gënjeshtarë". "Nuk janë 80 mijë aplikacione. Janë 60 mijë. Prokuroria ia ka huq. Nuk dua të shprehem keq, por ka gënjeshtarë", ka thënë Gucati. Ndërkaq avokati i OVL-UÇK-së, Gafurr Elshani, ka treguar në lidhje me takimin që ka pasur me zëvendësprokurorin i cili po merret me listat e veteranëve të remë. "Unë isha për të biseduar

me prokurorin special, por ai ishte jashtë vendit. Bisedova me zëvendësin e tij dhe ai më ka thënë se arsyeja se, kinse pse është bërë kjo listë, është konstatimi se nuk ka pasur dokumentacion të saktë të plotësuar nga ana e aplikuesve", ka thënë Elshani. Avokati Elshani ka thënë se prokuroria ka pranuar se ka bërë lëshime duke shtuar se është e mundur që një prokuror të mund të konstatojë se janë 20 mijë veteranë mashtrues. "Prokuroria duhet ta bëjë për secilin veteran nga një aktvendim. Po e përsëris, është bërë shkelje ligjore", ka thënë Elshani.

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati, në një intervistë për "Epokën e re" që ka dhënë para dy ditësh ka kritikuar prokurorinë për përfshirjen e veteranëve

të vërtetë në listën e "veteranëve të rrejshëm". Ai ka deklaruar se me këtë veprim prokuroria këtë proces e ka shpënë në një qorrsockak, duke krijuar mosbesim në organet e drejtësisë. "Prokuroria jo vetëm se duhet në mënyrë sa më të shpejtë t'i bëjë këto përmirësime, por duhet t'u kërkojë falje publike atyre individëve, emrat e të cilëve u njollosën, kurse munda dhe sakrificat e tyre u përlyhen në një listë, kinse ata kanë qenë veteranë të rrejshëm. Ndiem i zhgënjyer nga prokuroria se si ka arritur të bëjë gabime të tilla. Kjo është fyerje për veteranët e vërtetë, sepse as familjarët dhe miqtë e tyre sot nuk ndihen mirë. Tashmë as fëmijët e veteranëve në shkolla nuk e ndiejnë veten mirë, ndonëse baballarët e tyre kanë qenë luftëtarë të UÇK-së prej fillimit deri në përfundim të luftës", ka thënë Gucati.

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Përfaqësuesit e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në një konferencë për media mbajtur të mërkurën kanë thënë se Prokuroria Speciale e Kosovës ka bërë shkelje ligjore me nxjerrjen dhe publikimin e listës së veteranëve përfutës në mënyrë

të kundërligjshme.

Kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se prokuroria duke bërë publike listat e 20 238 veteranëve i ka shpallur ata të dyshuar, pa ua dhënë mundësinë të mbrohen dhe sfidohen me prova. Ai në konferencë për media ka kërkuar rivlerësim të këtij procesi. "Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës ta fillojë rivlerësimin e të gjithë këtij pro-

50 ushtarë të Gardës Kombëtare të Ajovës po qëndrojnë në Kosovë

PRISHTINË, 19 SHTATOR (ER) - Bazuar në Programin e Partneritetit Shtetëror Kosovë - Ajovë, përkatësisht të partneritetit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) me Gardën Kombëtare të Ajovës (ShBA), 50 pjesëtarë nga "Staff Ride", prej tyre oficerë dhe nënoficerë të Gardës Kombëtare të Ajovës, po qëndrojnë për vizitë në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në mjediset e FSK-së ushtarakëve të Gardës Kombëtare të Ajovës u ka uruar mirëseardhje komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, gjeneralbrigade Fadil Hadërgjonaj. Dhe më pas, në amfiteatrin e kazermës "Adem Jashari" është realizuar një takim informues nga rreshter majorët Genc Metaj dhe Fetah Zejnullahu, të cilët u fokusuan në historikun e FSK-së, arritjet e saj të deritanishme, misionin,

detyrat, strukturën, trajnimet/ushtrimet, bashkëpunimin me institucione të tjera etj. Krahas kësaj, pjesëtarët e kontingjentit amerikan dhe pjesëtarët e FSK-së filluan aktivitete të përbashkëta sportive në disa disiplina, të cilat do të zhvillohen edhe gjatë ditëve në vazhdim. Gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë ushtarakët amerikanë do të shoqërohen nga pjesëtarët e FSK-së dhe do të kenë mundësi të njihen edhe nga afër me kapacitetet e FSK-së, me kulturën dhe traditën shqiptare dhe të komuniteteve të tjera. Po ashtu, do të vizitojnë vende të rëndësishme në Kosovë si dhe do të zhvillojnë takime me liderët e FSK-së dhe të institucioneve të tjera. Ushtarakët e Gardës Kombëtare të Ajovës do të vazhdojnë të qëndrojnë në FSK deri më 21 shtator.



Flet për "Epokën e re", Haxhi Shala

Iniciativa për ushtri nuk



Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haxhi Shala, ka vlerësuar se iniciativa për transformimin e FSK-së në ushtri përmes ligjit është bërë në kohën e duhur. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky veprim është bërë në koordinim me faktorin ndërkombëtar. Shala ka thënë se transformimi i FSK-së është domosdoshmëri e kohës dhe nuk po bëhet për poenë politike e elektorale. Ai ka theksuar se meqë FSK-ja aktualisht nuk mund të transformohet në ushtri me ndryshime kushtetuese, atëherë duhet t'i jepen kompetenca me anë të ligjit. Sipas Shalës, kjo iniciativë për ushtri duhet të miratohet sa më shpejt në Kuvendin e Kosovës dhe jo të kthehet mbrapa siç ka ndodhur në të kaluarën

FSK-së është domosdoshmëri e kohës dhe nuk po bëhet për poenë politike dhe elektorale. Sipas Shalës, iniciativa për ushtri duhet të miratohet së shpejti në Kuvendin e Kosovës e jo të kthehet mbrapa siç ka ndodhur në të kaluarën. "Iniciativa për transformimin e FSK-së në ushtri nuk po bëhet për poenë politike, por sepse është domosdoshmëri e kohës. Dëshiroj që tri projektligjet që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së sa më shpejt të votohen në Kuvendin e Kosovës dhe të kryhet edhe kjo pjesë e mbetur në mënyrë që FSK-ja të marrë kompetenca të reja. Iniciativa për ushtri nuk duhet të kthehet mbrapa", është shprehur ai. Shala nuk sheh ndonjë pengesë në këtë proces, madje ai ka shprehur optimizëm se projektligjet për transformimin e FSK-së do t'i marrin mbi 100 vota në Kuvend.

"Epoka e re": Z. Shala, javën e kaluar Qeveria e Kosovës ka proceduar për miratim në Kuvend tri projektligje që kanë të bëjnë me transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri. Si e vlerësoni këtë iniciativë dhe a mendoni se është bërë në kohën e duhur?

Shala: Besoj se kjo iniciativë është bërë në kohën e duhur. Në fakt, deri më tani është vonuar nga Qeveria procedimi i këtyre projektligjeve për miratim në Kuvend. Sido që të jetë, besoj se Qeveria e Kosovës është koordinuar me partnerët ndërkombëtarë rreth këtyre projektligjeve. Si komision zyrtarisht ende nuk i kemi marrë këto projektligje për të parë nga afër se çfarë ka propozuar Qeveria me anë të këtyre projektligjeve dhe se cilat kompetenca do t'i shtohen FSK-së. Mirëpo, kurdo që të vijë në komision projektligjet për FSK-në, do t'i

është bërë në koordinim të plotë me partnerët ndërkombëtarë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se kjo iniciativë është bërë në kohën e duhur. "Besoj se kjo iniciativë është bërë në kohën e duhur. Në fakt, deri më tani është vonuar nga Qeveria procedimi i këtyre projektligjeve për miratim në Kuvend.

Sido që të jetë, besoj se Qeveria e Kosovës është koordinuar me partnerët ndërkombëtarë rreth këtyre projektligjeve. Meqë FSK-në nuk po mund ta transformojmë në ushtri me ndryshime kushtetuese, atëherë duhet t'i japim kompetenca me anë të ligjit", ka deklaruar Shala. Ai ka thënë se transformimi i

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haxhi Shala, ka thënë të mërkurën se iniciativa e Qeverisë së Kosovës për transformimin e FSK-së

duhet të kthehet mbrapa

rreth përmbajtjes së tyre.

"Epoka e re": Kuvendi këtë herë do t'i aprovojë këto projektligje dhe nuk do të ketë kthim pas me çështjen e ushtrisë sikurse që ka ndodhur në të kaluarën.

Shala: Tri projektligjet që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së dëshiroj që sa më shpejt të votohen në Kuvendin e Kosovës dhe të kryhet edhe kjo pjesë e mbetur, në mënyrë që FSK-ja të marrë kompetenca të reja. Iniciativa për ushtri nuk duhet të kthehet mbrapa. Besoj se Qeveria e Republikës së Kosovës është koordinuar me partnerët tanë ndërkombëtarë lidhur me procedimin e projektligjeve për transformimin e FSK-së dhe nuk është bërë gabim sikur më herët.

"Epoka e re": Siç po thonin edhe ju, më herët është ndërmarrë një iniciativë që FSK-ja të shndërrohet në ushtri përmes ligjit, por një gjë e tillë nuk është mbështetur nga NATO-ja, BE-ja dhe ShBA-ja, të cilat kanë insistuar që ky proces të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese. Këtë herë është çdo gjë në rregull dhe në këtë rrugëtim Kosova a do ta ketë mbështetjen e këtyre partnerëve?

Shala: Këtë herë besoj se Qeveria e Republikës së Kosovës është koordinuar me partnerët ndërkombëtarë dhe se këto projektligje do të kalojnë në Kuvend. Edhe partitë opozitare janë deklaruar pro këtyre projektligjeve, prandaj shumë shpejt do të ndodhë edhe aprovimi i tyre. Në këtë drejtim besoj se Kosova do ta ketë edhe mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë.

"Epoka e re": Kjo iniciativë nga një pjesë e opozitës po shihet për përfitime politike dhe elektorale. Po ndodh kështu si po thonë?

Shala: Nuk besoj se partitë opozitare e vlerësojnë veprimin e shndërrimit të FSK-së në ushtri si veprim për përfitime politike apo elektorale. Këtë pyetje e bëni ju gazetarët që përpiqeni të nxirrni diçka.

"Epoka e re": Jo, nuk është pyetje e ne gazetarëve, por janë deklarata të deputetëve opozitarë. Saktësisht deputeti i Vetëvendosjes, Ali Laçi, në një intervistë për gazetën "Epoka e re", të botuar në numrin e së martës, ka thënë se kjo çështje po bëhet për poenë politike ashtu siç ka ndodhur edhe në të kaluarën.

Shala: Mos i shtini me një thes të gjitha partitë opozitare. Duhet të cekni se ka thënë një deputet

i Vetëvendosjes, sepse Lëvizja Vetëvendosje të gjitha elementët po i sheh si poenë politike, e jo si domosdoshmëri e ngritjes së institucioneve në nivel vendi. Çdo gjë për Vetëvendosjen është e zezë. Iniciativa për transformimin e FSK-së në ushtri nuk po bëhet për poenë politike, por sepse është domosdoshmëri e kohës. Prandaj, ushtria duhet të bëhet sa më shpejt.

"Epoka e re": Vonesat që janë shkaktuar në këtë proces do të mund të rikuperohen?

Shala: Çdo vonesë e ngritjes së institucioneve është në dëm të vendit por, sidoqoftë, kur proceset janë të koordinuara me partnerët ndërkombëtarë, edhe

vonesat mund të evitohen.

"Epoka e re": Me këto projektligje parashihet që FSK-ja të marrë kompetenca dhe detyra të reja, por nuk do t'i ndryshohet emri. Paraqet problem një gjë e tillë?

Shala: Nuk ka rëndësi fare emri. Të rëndësishme janë kompetencat dhe detyrat që do t'i shtohen FSK-së. Ka plot ushtri në botë që emrin nuk e kanë të tillë, por e kanë fuqinë dhe misionin ushtarak.

"Epoka e re": Me miratimin e këtyre tri projektligjeve FSK-ja do të marrë mision ushtarak?

Shala: Sapo e merr mbrojtjen e tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës ajo është gjithçka që duhet të ketë.

"Epoka e re": Mund të ketë ndonjë pengesë deri në finalizimin e këtij procesi, meqë Lista Serbe ka bërë me dije se nuk do ta përkrahë këtë iniciativë?

Shala: Nuk besoj se do të ketë ndonjë pengesë. Besoj se transformimi i FSK-së do të kalojë në Kuvend meqë është koordinuar me faktorët ndërkombëtarë. Lista Serbe mund të mos votojë pro kësaj iniciative apo edhe mos të qëndrojë në seancë në kohën kur të votohen projektligjet për transformimin e FSK-së, por nuk mund të paraqesë ndonjë pengesë. Shumica shqiptare dhe komunitetet e tjera pakicë janë për. Besoj se projektligjet për ushtrinë do t'i marrin mbi 100 vota në Kuvend.

QKSS-ja: Serbia ka bërë trysni ndaj pjesëtarëve të FSK-së të komunitetit serb

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Serbia "ka bërë agresion" ndaj Forcës së Sigurisë së Kosovës, "duke ushtruar dhunë" për tërheqjen e pothuajse 50 për qind të pjesëtarëve serbë nga FSK-ja, thuhet në një raport të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Sipas kësaj qendre, ky numër mund të rritet në muajt e ardhshëm nëse nuk ndërmerren masat e duhura nga institucionet e Kosovës dhe partnerët ndërkombëtarë. "Si mjet presioni janë përdorur kërcënimet për largimin nga paga/pensionin i familjarëve të ngushtë dhe të gjerë të këtyre pjesëtarëve dhe ndalim-hyrja në Serbi. Hulmuesit e QKSS-së kanë gjetur se janë bërë trysni psikologjike dhe janë përdorur metoda speciale, ku këtyre pjesëtarëve u është transmetuar se, kinse së shpejti do të ketë luftë

në mes të Serbisë dhe Kosovës dhe se ata do të përfundojnë duke luftuar kundër vëllezërve të tyre serbë të Armatës Serbe", thuhet në raportin e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Rol të drejtpërdrejtë në këtë operacion, sipas këtij raporti, ka pasur presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ministri i Mbrojtjes i Serbisë, Aleksandar Vulin, kryetari i Komisionit Parlamentar serb për Kosovën, Millovan Drecun, si dhe eksponentë të subjektit politik Lista Serbe në territorin e Kosovës. Raporti i rekomandon Qeverisë së Kosovës që në bashkëpunim me praninë ndërkombëtare të bëjë plan për ta parandaluar largimin më tutje të pjesëtarëve serbë të FSK-së, përderisa Shtetet e Quintit (ShBA-ja, Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe

Italia) duhet ta kushtëzojnë Serbinë në kontekst të integritetit në BE lidhur me veprimtarinë e saj të vazhdueshme në dëm të FSK-së dhe institucioneve të tjera. "Shtetet e Quintit duhet ta kushtëzojnë Serbinë në kontekst të integritetit në BE lidhur me veprimtarinë e saj të vazhdueshme në dëm të FSK-së dhe institucioneve të tjera", ka theksuar organizata e Kosovës që merret me studime të sigurisë. Si zgjidhje të kësaj situatë, hulmuesit e Qendrës për Studime të Sigurisë rekomandojnë që Ministra e Forcës së Sigurisë ta bëjë rekrutimin e ri të pjesëtarëve serbë si kundërmasë ndaj veprimeve të Serbisë. Vetëm në pjesën e parë të këtij viti mbi 60 pjesëtarë serbë të FSK-së i kanë dorëzuar kërkesat për dorëheqje nga ky institucion.

shqyrtojmë dhe do të shikojmë nëse ka hapësirë për të ndërhyrë. Grupi punues do ta kryejë punën e vet dhe menjëherë do t'i procedojmë për votim në seancën parlamentare. Meqë FSK-në nuk po mund ta transformojmë në ushtri me ndryshime kushtetuese, atëherë duhet t'i japim kompetenca me anë të ligjit.

"Epoka e re": Edhe pse nuk kanë ardhur ende në komision, keni pasur mundësi ta shikoni përmbajtjen e këtyre projektligjeve.

Shala: Si kryetar i komisionit jam koordinuar me ministrin e FSK-së dhe të tjerët që kanë punuar për hartimin e këtyre projektligjeve. Pasi t'i shqyrtojmë në komision mund të flasim më konkretisht për atë se çfarë përmbajnë projektligjet për FSK-në. Përderisa nuk i kemi pranuar zyrtarisht nuk besoj se do të ishte mirë të deklarohemi



Shtohet bashkëpunimi i QKUK-së me Qendrën Klinike HUG të Gjenevës

PRISHTINË, 19 SHTATOR (ER) - Një delegacion i Qendrës Klinike Universitare HUG nga Gjeneva, me organizim të Konsultës së Kosovës në Gjenevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Odën Ekonomike Zvicerane, po viziton Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Në fokus të vizitës është iniciimi i bashkëpunimit ndërmjet QKUK-së dhe Qendrës Klinike Universitare HUG nga Gjeneva.

Drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, ka bërë një prezantim të punës së Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, përfshirë numrin e të punësuarve dhe shërbimet shëndetësore që ofrohen nga njësitë përbërëse të ShSKUK-së. Ai ka folur për nevojën që ka QKUK-ja për trajnime të stafit qoftë atij të mesëm, por edhe mjekëve në fusha të caktuara. Sejdiu rikujtoi se nga vizita e delegacionit të QKUK-së dhe

Ministrisë së Shëndetësisë në HUG ishte biseduar rreth iniciimit konkret të bashkëpunimi në lidhje me trajnimin e infermierëve dhe mjekëve në fusha të caktuara.

Përfaqësuesit e delegacionit nga HUG do të qëndrojnë dy ditë në QKUK dhe disa spitale të përgjithshme, në të cilët do t'i shohin kushtet e punës dhe nevojën për shtim të bashkëpunimit për aftësimin dhe avancimin e infermierëve.



Drejtori i ShSKUK-së: Nuk do të lejojmë anarki

Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), dr. Basri Sejdiu, ka folur të mërkurën rreth masave të fundit disiplinore që janë marrë ndaj mjekëve që nuk janë gjetur në kujdestari. Ai ka thënë se çdo mjek dhe infermier që punon në kujdestari duhet të jetë në vendin e punës, përndryshe do të përballet me pasojë

gjetur në kujdestari. Ai ka sqaruar se masat e ndërmarra ndaj mjekëve nuk janë politike, as personale siç ka pasur komente në rrjetet sociale dhe media. Sipas Sejdiut, nuk do të lejohet të ketë anarki pasi anarkia rrezikon institucionin. Duke sqaruar masat e ndërmarra, drejtori Sejdiu ka shpjeguar se rastet e fundit të suspendimit kanë ndodhur për shkak të mungesës së tyre në vendin e punës. Ai ka deklaruar se askush nuk mund të arsyetohet se është profesionist i madh dhe të mos jetë i rregullt në kujdestari, qoftë

edhe një minutë. "Çdo mjek dhe infermier në kujdestari duhet ta dijë se duhet të jetë në orar çdo minutë. Vetëm një të shtunë një mjek merr diku rreth 170 euro për kujdestari. Janë komisionet ato që kanë bërë inspektimet. Asnjë suspendim nuk ka ndodhur pa fakte", u shpreh drejtori Sejdiu.

Në konferencë për medie drejtori Sejdiu ka folur edhe për investimet e fundit që po bëhen në ShSKUK, përfshirë pajisjen me aparatura të reja moderne, përmirësimin e infrastrukturës, duke sqaruar se po përpiqen që

qendra të jetë pacienti, që ai të ketë qasje sa më të lehtë dhe sa më të mirë. Sipas tij, janë pranuar në punë 180 infermierë dhe 80 mjekë specialistë me qëllim që shërbimi të jetë sa më cilësor. "Stafi të ofrojë shërbime që krejt kjo të bëhet për të mirën e pacientit. Të gjithë ne mund të jemi pacientë. Nuk merret asnjë masë që ta lëndojë individin, por në të mirë të institucionit dhe krijimit sa më të madh të sigurisë për pacientin. Vendimet e tilla merren gjithmonë në përputhje të legjislaturës në fuqi", ka thënë Sejdiu.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të

Kosovës (ShSKUK), dr. Basri Sejdiu, ka mbajtur të mërkurën një konferencë për medie, në të cilën ka folur në lidhje me masat e fundit disiplinore që janë marrë ndaj mjekëve që nuk janë

Ndërron jetë rapsodi Hashim Shala

PRISHTINË, 19 SHTATOR (ER) - Rapsodi i njohur Hashim Shala ka ndërruar jetë të mërkurën në moshën 82-vjeçare. Vdekjen e tij e ka konfirmuar këngëtari Ismet Bogujevci përmes profil-it të vet në "Facebook", duke shkruar: "U prehsh në paqe bilbili i këngës folklorike!" Shala njihet më së miri për duetet me mikun e vet Tahir

Drenicën. "Kënga dhe koloriti i zërit të tyre hyri në çdo vatër. Gjatë periudhës shumëvjeçare të shoqërimit të tij me këngën, ka marrë pjesë në shumë manifestime e festivale të vendit dhe jashtë, është kurorëzuar me mirënjohje e shpërblime të niveleve më të larta, si ajo në Munih të Gjermanisë, Danimarkë, Bruksel, në Nju

Jork e Çikago të Amerikës", thuhet në një jetëshkrim të tij. Shala kompozoi 169 këngë dhe publikoi disa albume muzikore. Rapsodi Hashim Shala ka jetuar dhe vepruar në Prishtinë. Familjes Shala i kanë shprehur ngushëllime përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe komuniteti artistik.



Kërkohet lirimi i Sylejman Selimit dhe Jahir Demakut

Sami Lushtaku: Sylejman Selimi nuk është i burgosur, por i kidnapuar

Qytetarë, bashkëlufëtarë dhe udhëheqës të shoqatave të dala nga lufta kanë protestuar të mërkurën para Pallatit të Drejtësisë në Hajvali për lirimin nga burgu të gjeneral Sylejman Selimit dhe Jahir Demakut. Avokati i Selimit, Tomë Gashi, duke kërkuar lirimin e Sylejman Selimit, ka thënë se ai padrejtësisht dhe politikisht po mbahet në burg, ndërkaq ish-kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, ka thënë se Sylejman Selimi nuk është i burgosur, por i kidnapuar

kundërligjshme. "Fillimisht janë dënuar në mënyrë krejtësisht të kundërligjshme, pa asnjë provë kredibile, vetëm për ta plotësuar dëshirën e dikujt. Pas të gjithë ankesave që ne kemi bërë, Gjykata Supreme e ka anuluar krejtësisht, qysh më 11 qershor të këtij viti, aktgjykimin e Sylejman Selimit, Jahir Demakut dhe të tjerëve dhe ka urdhëruar që rasti të kthehet në rigjykim dhe rivedosje", ka thënë Gashi.

Kryetari i Shoqatës së Familjeve

të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, ka kërkuar lirimin e ish-komandantit të UÇK-së, Sylejman Selimi dhe të tjerëve pasi, sipas tij, ishin kontribuues të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Ndërsa bashkëlufëtarë i Selimit dhe organizatori i protestës Arton Hoti ka theksuar se tash e tre muaj Selimi po mbahet në burg pa asnjë të drejtë. Lirimin nga paraburgimi e ka kërkuar edhe bashkëshortja e Sylejman Selimit, Kimete Selimi. Ajo ka thënë se ka më shumë se pesë vjet që janë duke u përballur me padrejtësitë dhe kjo po përjetohet rëndë nga fëmijët e tyre.

Pjesë e kësaj proteste ishte edhe ish-kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, i cili ka thënë se Sylejman Selimi nuk është i burgosur, por i kidnapuar. "Për mjetet ligjore foli edhe avokati më herët, kështu që besoj se Sylejman Selimi nuk është i burgosur, është i kidnapuar realisht, por ajo që kërkojmë është se drejtësia ta japë fjalën e fundit dhe Sylejman Selimi të lirohet dhe t'i kthehet familjes së vet, miqve, dashamirëve dhe këtij vendi, i cili ka shumë nevojë edhe për Sylën", ka thënë Lushtaku.

Protestuesit janë shpërndarë të qetë dhe organizatorët kanë paralajmëruar protesta edhe në të ardhmen deri në lirimin e "Grupit Drenica" nga burgu. Më 24 maj 2013 gjeneral Sylejman Selimi ishte arrestuar dhe më vonë u shpall fajtor për një vepër penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile nga Gjykata Themelore në Mitrovicë. Ai u dënua me gjashtë vjet burgim. Më 7 qershor 2018 është mbajtur rigjyrimi për "Drenica 2", kurse më 11 qershor për "Drenica 1".

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Qindra qytetarë u mblodhën të mërkurën para Pallatit të Drejtësisë në Prishtinë për ta

kërkuar lirimin e gjeneralit të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimit, për rastin "Drenica 2". Sipas organizatorëve të protestës, Selimi dhe të tjerët po mbahen padrejtësisht në

burg duke mos sjellë asnjë vendim të ri tash e një kohë. Avokati mbrojtës Tomë Gashi para protestuesve ka thënë se mbajtja në paraburgim për pesë vjet pa asnjë vendim gjyqësor është e



Sot mbahet seanca e jashtëzakonshme për marrëveshjet ndërkombëtare

Prishtinë, 19 shtator - Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka marrë vendim që sot (e enjte) në orën 14:00 të mbahet seancë e jashtëzakonshme për ratifikimin e tri marrëveshjeve ndërkombëtare. Seanca do të mbahet me kërkesën e partive opozitare dhe dy deputetëve të pavarur. Këto janë marrëveshjet që do të ratifikohen: Marrëveshja Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa

për qytetarët"; dhe Marrëveshja ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS +" Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport. Po ashtu, deputetët do ta shqyrtojnë edhe Projektligjin nr. 06/L-099 për aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA). Pas përfundimit të kësaj seance, Kuvendi do t'i vazhdojë punimet me pikat e mbetura nga seanca e datës 14 shtator.



Intervistë me kryetarin e Rinisë Demokratike të Kosovës (RDK), Donjet Bislimi

Rinia në PDK, bartëse e platformës së Dekadës së Re

Kryetari i Rinisë Demokratike të Kosovës (RDK), Donjet Bislimi, në një bisedë për gazetën "Epoka e re" ka theksuar se të rinjtë e të rejtat po e përqafojnë gjithandëj Kosovës mesazhin dhe vizionin e platformës së Dekadës së Re që, sipas tij, kjo platformë thërret në besim në shtetin e Kosovës dhe në njëri-tjetrin, që bashkërisht ta zhvillojnë shtetin dhe ta integrojnë në familjen e madhe evropiane



EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 19 SHTATOR -

"Epoka e re": Z. Bislimi, për më shumë se dy muaj jeni zgjedhur kryetar i Rinisë Demokratike të Kosovës. Cili ka qenë angazhimi juaj i deritashëm dhe cili është vizioni juaj?

Bislimi: Përpos koordinimit dhe strukturimit të organeve rinore deri në nivel nëndege, në këta dy muaj i kemi kushtuar rëndësi vendosjes së disa standardeve të nevojshëm për zhvillimin e aktiviteteve dhe për kultivimin e shpirtit aktivist rinor përmes dhjetëra, mund të them qindra aktiviteteve të ndërmarra në të gjitha degët dhe nëndegët e rinisë demokratike. Të gjitha janë dhe do të mbeten të bazuara në vizionin tonë të ngritjes së vetëdijes politike rinore, vlerësimit real dhe korrekt të situatave, meritave dhe emancipimit të nevojshëm politik rinor në frymën e politikave të Partisë Demokratike të Kosovës. Të rinjtë e të rejtat po e përqafojnë gjithandëj Kosovës mesazhin, vizionin e platformës së Dekadës së Re, e cila, para së gjithash, thërret në besim në shtetin e Kosovës, në njëri-tjetrin, që bashkë ta zhvillojnë vendin tonë e ta integrojnë aty ku e ka vendin, në familjen e madhe evropiane.

"Epoka e re": Ku qëndron PDK-ja tani në terren, në organizim?

Bislimi: Procesi zgjedhor në Rininë Demokratike të Kosovës ka qenë shembull i një organizimi të madh dhe shumë transparent. Mbi 20 mijë të rinj janë përfshirë në këtë proces zgjedhor në çdo cep të

Kosovës dhe mijëra të tjerë të rinj i kanë dhënë përkrahje platformës sonë. Me këtë ne kemi dëshmuar edhe një herë se jemi forca politike më e madhe në vend, me strukturën më të fuqishme, me organizimin më të mirë dhe me platformën më të duhur për Kosovën. PDK-ja do ta vazhdojë tani procesin zgjedhor në strukturat drejtuese në nivel degësh dhe në nivel qendror. Fryma që ka përcjellë zgjedhjet në rini po e përcjellë edhe këtë tani. Janë reforma të rëndësishme që po bëhen, platformë e duhur për Kosovën në periudhën që po hyjmë. Kosova ka pasur nevojë për PDK-në, për forcën dhe vullnetin e saj për të ndryshuar e transformuar vendin. Dhe ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë.

"Epoka e re": Sa mendoni se institucionet tona po punojnë për rininë?

Bislimi: Natyrisht se gjithmonë ka sfida dhe nevoja të reja. Rinia nuk është e ndarë nga zhvillimi i gjithëmbarshtëm në vend. Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në çdo fushë dhe çka është më e rëndësishme, rinia ka qenë pjesë e vendimmarrjes në çdo hap. Dua të them se unë jam krenar që jam pjesë e PDK-së, subjektit që më së shumti i ka dhënë hapësirë rinisë dhe më së shumti ka investuar te rinia, qoftë në edukim, në krijimin e një ambienti ekonomik për më shumë vende pune. Rinia në PDK është pjesë e lidhshimit drejtues të partisë. Kosova e vitit 2007, kur PDK-ja erdhi në qeverisje, dallon shumë nga kjo e sotme. Kujtojeni pak atë kohë, mënyrën se si kemi jetuar dhe si jetojmë tash. Ka dal-

lim të madh në kuptimin pozitiv, me infrastrukturë rrugore moderne, shkolla e universitete moderne, paga më të larta, infrastrukturë sportive, bujqësi të rimëkëmbur e shumë e shumë transformime të tjera. A ka nevojë për shumë më shumë? Natyrisht se po. Dhe për këtë ne do të punojmë bashkë me lidhshimin e PDK-së, me kryetarin Veseli për t'i arritur ato.

"Epoka e re": PDK-ja do t'i vazhdojë tash zgjedhjet e brendshme në nivel të përgjithshëm të degëve dhe strukturave drejtuese. Ku do të jetë rinia në këtë proces?

Bislimi: Rinia ka rol kyç në të gjitha proceset e brendshme partiake, duke filluar nga puna organizative deri tek ajo vendimmarrëse si

pjesë e kryesisë së partisë, por edhe e marrjes së përgjegjësisë institucionale më pastaj. Ne do të jemi pjesë e barabartë e organizimit dhe zgjedhjeve, para së gjithash do të punojmë shumë që procesi të ecë në mënyrën më të mirë.

"Epoka e re": Të rinjtë tanë nuk mbesin jashtë temave të mëdha siç është liberalizimi i vizave, por edhe dialogu. Sa shpesh i diskutoni këto dhe cili është opinionin juaj?

Bislimi: Partia Demokratike e Kosovës udhëhiqet nga njerëzit që kanë kontribuar më së shumti për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Janë njerëz që kanë sjellë ndryshimet e nevojshme në këtë vend, që kanë dalë në ballë të pro-

ceseve dhe kanë pasur guximin të marrin vendime të mëdha dhe të duhura për popullin. Ne besojmë në vizionin dhe angazhim për vendin të kryetarit Kadri Veseli. Rinia do të jetë përkrahëse e ideve dhe qëndrimeve tashmë të shprehura për fazën në të cilën ndodhemi. Unë nuk do të dëshiroja që rinia, gjeneratat e tjera që do të vijnë, të kenë barrë probleme të hapura me cilindo shtet fqinj. Konsideroj se Kosova duhet të ketë konsensus, atë që kryetari Veseli po insiston dhe po punon për të tash e sa muaj. Ai është i vetmi që ka prezantuar një platformë të qartë për fazën finale të dialogut. Gjithashtu, presim që uniteti të na përcjellë edhe deri në vendimin final për heqjen e vizave. Rinia ka nevojë të shohë nga e ardhmja.



EULEX-i përkujton doganierin e vrarë në veri

PRISHTINË, 19 SHTATOR (ER) - Të mërkurën u bënë pesë vjet kur Audrius Shenavičius e humbi jetën derisa po shërbente doganier i EULEX-it. Audriusi u vra si pasojë e të shtënave me armë gjatë kohës kur ai me kolegët po shkonin me makinë në pikën doganore në veri të Kosovës për ta filluar ndërrimin e tyre të punës. "Sot ne e ndero-

jme kolegun tonë të dashur Audrius Shenavičius i cili u vra në krye të detyrës. Audriusi e sakrifikoji jetën në shërbim të vlerave dhe parimeve më të larta, duke kontribuar me përkushtimin, profesionalizmin dhe përvojën e tij për ta përmirësuar jetën e qytetarëve të Kosovës", ka thënë shefja e misionit të EULEX-it, Alexandra

Papadopoulou. EULEX-i edhe një herë i bën thirrje secilit që mund të ketë informata të cilat mund të jenë të dobishme për hetimet, që të paraqiten pa hezitim. Ky mision ka vënë në dispozicion një shpërblim prej 82 000 eurosh për çfarëdo informate që sjell deri te arrestimi i kryerësit(ve) të kësaj vrasje.

Kuvendi i Kosovës shpenzoi 48 për qind të buxhetit për paga dhe mëditje

Sekretari i Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka paraqitur të mërkurën, në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në pika të shkurtra shpenzimet e Kuvendit. Ai ka treguar se për paga dhe mëditje është shpenzuar 48 për qind e buxhetit, për mallra dhe shpenzime 25 për qind, për shpenzime komunale 25 për qind, kurse për shpenzimet kapitale është shpenzuar buxhet vetëm 1.5 për qind



**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Përfaqësuesit e Komisionit për Buxhet dhe Financa kanë mbajtur të mërkurën mbledhjen e rregullt në të cilën kanë diskutuar për raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës, Projektligjin për ratifikimin e huas nga EIB për autostradën Kijevë - Zahaq, Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale dhe Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave. Sa i përket raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës, sekretari i këtij institucioni, Ismet Krasniqi, ka paraqitur në pika të shkurtra shpenzimet e Kuvendit. Ai ka treguar se për paga dhe mëditje është shpenzuar 48 për qind e buxhetit, për mallra dhe shpenzime 25 për qind, kurse për shpenzimet kapitale është shpenzuar buxhet vetëm 1.5 për qind. Ndërkaq sa i përket shpenzimeve kapitale është dhënë

vërejtje nga anëtarët e komisionit sa i përket shumës 1.5 për qind, ndërsa deputeti i Nismës Socialdemokrate, Enver Hoti, ka hedhur dyshime në këtë pikë, duke pohuar se kjo shifër e shumës është përsëritur. Kurse sekretari i Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka thënë se kjo përqindje e vogël është për shkak të zgjatjes së procedurave të prokurimit. "38 për qind e buxhetit të paraparë është shpenzuar në gjashtëmujorin e parë. Shpenzimet kapitale janë duke vazhduar nëpër procedura të prokurimit dhe kjo po merr kohë shumë të gjatë. Ne shpresojmë se edhe ky shpenzim do të jetë në nivelin e parashikuar", ka thënë Krasniqi.

Në këtë mbledhje u shqyrtua edhe marrëveshja për hua ndërmjet Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e Autostradës Prishtinë - Pejë, segmenti Kijevë - Zahaq. Ministri i Financave, Bedri Hamza, gjatë

prezantimit të kësaj marrëveshje ka thënë se kjo marrëveshje është ndër më të mëdhatë që Kosova ndonjëherë ka arritur. "80 milionë euro kredi nga Banka Evropiane për Investime, është marrëveshja më e favorshme që Kosova ka arritur. Sipas kësaj marrëveshje, afati i kthimit është 30 vjet, kurse grejs-perioda pesë vjet", ka deklaruar Hamza.

Mirëpo deputetja Arbërie Nagavci ka shprehur shqetësimin që Kosova po hyn në borxhe të mëdha. Kurse ministri Hamza në replikën e tij u zotua se nuk do të nënshkruajë marrëveshje e cila nuk i sjell përfitim vendit. "Kosova vazhdon të jetë me borxhin më të ulët në rajon që aktualisht sillet

prej 16 përqindësh të bruto-prodaktit. Për projektet që kanë përfitim duhet t'i shfrytëzojmë mundësitë e tjera për financim. Po ju them se nuk negocioj dhe nuk e fus vendin në borxh për projektet që nuk kanë arsyeshmëri", ka thënë Hamza.

Po në mbledhjen e këtij komisioni ka raportuar edhe kryesuesi i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Petrit Gashi, për raportin e vitit 2017. Ai ka thënë se sa i përket punës së AKP-së është shënuar progres në fushën e ofertuesve. "Kemi pasur një vit të mirë në vitin 2017. Por, një nga brengat tona mbetet vendimi për pezullimin e shitjes së tokave të ndërmarrjeve shoqërore. Ne kemi

biseduar dhe me aktorë të Qeverisë dhe na është thënë se ky vendim është i përkohshëm. Kjo e ka ngushtuar harmonizimin e punës sonë pasi në këtë e kemi paraparë në planifikimin e punës për vitin 2018. Qeveria ka shpronësuar prona që janë të ndërmarrjeve shoqërore dhe për këtë nuk janë kthyer pagesat. Po ashtu, sfidë tjetër kemi edhe çështjen e Dhomës së Veçantë pasi është paralizuar puna me shkuarjen e gjyqtarëve të EULEX-it. Pos kësaj, kemi problem dhe me objektin ku funksionojmë, pasi është objekt i vjetruar dhe konsiderohet i rrezikshëm", ka thënë Gashi. Me shumicë votash kanë kaluar të gjitha projektligjet dhe marrëveshjet.

Nënshkruhet marrëveshja me kompanitë rajonale të ujësjellësve për pagesën e borxhit prej 1.5 milion eurosh



PRISHTINË, 19 SHTATOR (ER) - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka pritur të mërkurën në takim kryeshefat ekzekutivë të kompanive rajonale të ujësjellësve, "Prishtina", "Ibër Lepenci", "Bifurkacioni", "Hidromorava", "Gjakova", "Hidroregjioni Jugor" dhe "Hidrodrini", me të cilët ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi për pagesën e taksës ujore. Sipas këtyre marrëveshjeve,

Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) në aftat prej pesë vjetësh do ta paguajnë borxhin e vjetër 10 vjet që kanë ndaj MMPH-së prej 1.585.654.370 eurosh, duke filluar nga ky muaj me 20 për qind, për të vazhduar edhe katër vjet të tjera, me nga 20 për qind të pagesës.

Në ceremoninë e nënshkrimit të memorandumeve ministri Matoshi ka thënë se qëllimi i këtyre marrëveshjeve është programimi dhe shlyerja e borxhit

të akumuluar prej viteve 2007-2017 nga këto kompani. Matoshi ka bërë me dije se Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) nuk mund të pajisen me leje ujore nga MMPH-ja në rast të mospagesës prej 20 përqindësh të borxhit në muajin shtator.

Ndërsa kryeshefi i KRU "Prishtina", Ilir Abdullahu, ka thënë se është lajm i mirë fillimi i pagesës së taksës, derisa ka shtuar se mospagimi i borxhit nuk do të përsëritet.

Tensionet tregtare ShBA - Kinë përfshijnë edhe Kosovën

Prishtinë, 19 shtator - Tensionet tregtare në mes të Shteteve të Bashkuara (ShBA) dhe Kinës mund të ndikojnë edhe në Kosovë, përkatësisht në Fondin

e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Jeton Demi, zyrtar për Informim në Trust, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Fondi i

Kursimeve Pensionale (FKPK-ja) deri më 31 gusht kishte nën menaxhim 1,733,804,055 euro. Mirëpo, sipas tij, ky vit është duke u ndikuar negativisht nga

tensionet tregtare në mes të ShBA-së dhe Kinës. Ai ka thënë se këto tensione rrezikojnë potencialin e zhvillimit botëror ekonomik dhe jo vetëm.

"Megjithatë, FKPK-ja deri më 13 shtator 2018 qëndron në kuota të lehta pozitive, me një kthim bruto për vitin prej afër 12 milionë eurosh", ka thënë Demi.

Pajtohen për shkëmbim të informacioneve në fushën e kadastrës

MITROVICË, 19 SHTATOR (ER) - Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë në Komunën e Mitrovicës, Egzon Jashari, i shoqëruar nga zyrtarë komunalë të Zyrës së Kadastrës, kanë vizituar Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me ç'rast janë pritur nga kryeshefi ekzekutiv i kësaj agjencie, Avni Ahmeti. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i projekteve aktuale në insti-

tucionet përkatëse si dhe identifikimi i fushave të interesit ku bashkëpunimi në fushën e kadastrës dhe administrimit të tokës dhe regjistrave pronësorë do të mund të shtohet.

Të dyja palët në takim janë pajtuar për shkëmbimin sa më të shpejtë të informacioneve, duke pasur parasysh se nga një veprim i tillë do të përfitonin institucionet dhe qytetarët e Republikës së Kosovës.



Sot përrurohen shtatorët e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci

DRENAS, 19 SHTATOR (ER) - Sot (e enjte) në Drenas, në orën 12:00, do të bëhet përrurimi i shtatorëve të heroit Fehmi Lladrovci dhe heroinës Xhevë Krasniqi-Lladrovci. Kjo komunë nëpërmjet një njoftimi për medie ka kërkuar nga qytetarët e Drenasit të mos i

parkojnë veturat në hapësirat publike. "Të nderuar qytetarë të Komunës së Drenasit, të enjten, më 20 shtator 2018, me rastin e shënimit të 20-vjetorit të rënies së heroit të Kosovës, Fehmi Lladrovci dhe heroinës Xhevë Krasniqi-Lladrovci, do të mbahet man-

ifestimi për përrurimin e shtatorëve të heronjve në orën 12:00 në Sheshin 'Fehmi Lladrovci', ndaj përmes këtij njoftimi kërkojmë nga të gjithë qytetarët të mos parkojnë veturat në hapësirat publike", ka njoftuar Komuna e Drenasit.



Jashari dhe Latifi, pjesë e konferencës për efijencën e energjisë

SKENDERAJ, 19 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, dhe ai i Rahovecit, Smajl Latifi, kanë marrë pjesë të mërkurën në konferencën e parë të kryetarëve të komunave të Kosovës, rreth mbështetjes së Bashkimit Evropian lidhur me zbatimin e Ligjit të ri për efijencën e energjisë dhe krijimin e fondit për efijencë të energjisë në Kosovë.

Ngjarja kryesore e konferencës ka qenë inaugurimi i Kartës së

Energjisë të kryetarëve të komunave të Kosovës si një deklaratë e angazhimit për ta përmirësuar nivelin e komfortit në të gjitha ndërtesat komunale, duke zbatuar projekte të efijencës së energjisë dhe të energjisë së ripërtërishtme dhe për ta zvogëluar ndotjen e mjedisit në komuna, si dhe për t'i kursyer shpenzimet për energji.

Me nënshkrimin e "Kartës së Energjisë" kryetarët e komunave të Kosovës do ta hapin rrugën për pranimin e komunave individuale

në Konventën e kryetarëve të komunave të BE-së, që hap mundësi për financim për përmirësimin e infrastrukturës komunale të energjisë.

Gjatë mbajtjes së kësaj konference kryetari Latifi ka nënshkruar dokumentin "Karta e Energjisë e Komunave të Kosovës", me ç'rast ka pohuar se Kosova po hyn në një fazë të re të aplikimit më të suksesshëm të zbatimit të planeve dhe masave për efijencë të energjisë.

Sigurohet uji për shkollën në fshatin Bubavec

MALISHEVË, 19 SHTATOR (ER) - Në kuadër të përgatitjeve për hapjen e objektit të ri të shkollës në fshatin Bubavec, të mërkurën kanë filluar punimet për hapjen e pusit dhe për sigurimin e ujit për këtë objekt të ri shkollor.

Hapjen e pusit e ka parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili ishte i shoqëruar edhe nga drejtorët e tjerë komunalë dhe drejtori i shkollës në Bubavec, Maliq Kryeziu. "Për hapjen e objektit të ri të shkollës duhet të plotësohen të gjitha parakushtet edhe për mirëm-

bajtjen e saj, duke filluar nga sigurimi i ujit, si element jetik dhe këtë jemi duke e bërë. Shkolla duhet t'i ketë të gjitha kushtet e nevojshme për nxënës dhe ne jemi duke punuar në këtë drejtim me qëllim që objektit të ri të shkollës të mos i mungojë asgjë", ka thënë Berisha.

Drejtori i shkollës në Bubavec, Maliq Kryeziu, e ka falënderuar Komunën e Malishevës për përkushtim e saj për sigurimin e kushteve për hapjen e objektit të ri të shkollës dhe për krijimin e kushteve për zhvillim normal të procesit edukativo-arsimor.



UÇK-ja e ka përfunduar misionin e vet fisnik. Lëreni rehat

Fushata kundër UÇK-së?



Jakup KRASNIQI

Fushata kundër Ushtrisë Çlirimtare nuk është e re. Ajo ka filluar që në ditët e para të lindjes së saj dhe nuk ka pushuar as gjatë luftës dhe as pas saj. Ka vazhduar deri në ditët e sotme. Kësaj lufte të turpshme, të pandërprerë që nga viti 1993/94 e në vazhdim, në mënyrë të organizuar nuk i është përgjigjur asnjë komunitet i organizuar i shoqërisë sonë, filluar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, sistemi i drejtësisë e as ndonjë segment i politikës shqiptare në përgjithësi, qofshin ata në pushtet apo në opozitë. Madje sot nuk po dihet se kush më shumë është duke e

dëmtuar. Ata që nuk e deshën kurrë, pse luftën çlirimtare nuk e patën qëllim apo ata që nuk po dinë ta mbrojnë e ta duan kryeveprën e tyre! Bindja ime është se këta të fundit janë duke ia dhënë grushtin e fundit, grushtin e nokdaunit klasik. Prandaj, populli ynë nuk thotë kot, "dikush donë t'i ngjet vetullat, e t'i nxjerrë edhe sytë". Sytë nuk t'i nxjerrin pse atë e kanë qëllim, por pse nuk dinë! Padija është nena e budallalëkut! Padija me arrogancën kur bëhen bashkë nuk e humbin vetëm një vlerë. Ato e humbin edhe shtetin. Vlerën po e shoh të rrënuar për toke, por cili do të jetë fati i shtetit me këtë shkallë të lartë të padijes në qeverisje e shtetndërtim?! Një gjë duhet të jetë e qartë për çdo kontribuues të lirisë, të çlirimit, të pavarësisë e të shtetndërtimit! Padija, lakmia, grykësia, shpirtngushtësia, kanë përmbysur edhe shumë perandori milionëshe e jo më shtete minore si ky yni. Kujton esëll Perandorinë Osmane, Sovjetike dhe Jugosllave!

Prandaj, këto vese shkatërrimtare për demokracinë e shtetndërtimin, domosdo duhet t'ua lëshojnë vendin atyre që dinë, që duan dhe e kanë përkushtimin për ta ndërnuar shtetin e së drejtës, shtetin për të cilin janë bërë të gjitha sakrificat e kombit që nga vitet 1912/1913 e deri në luftën e fundit 1998/99. Një gjë duhet ta dimë të gjithë, si luftëtarët e rrejtshëm e më shumë ata të vërtetët e akoma më shumë ata që duan ta ruajnë pushtetin me votuesit "luftëtarë", le ta dinë se bash ata po bëhen rrënues të ardhmërisë së kombit në përgjithësi e të rinisë në veçanti. Koha është për një reflektim të thellë sa nuk është bërë vonë! Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës sot nuk janë duke e dëmtuar kundërshtarët e saj tradicionalë brenda dhe jashtë Kosovës. Jo, janë duke e dëmtuar ata që po e pengojnë funksionimin e shtetit të së drejtës, bash ata që po thirren në luftën dhe kontributin personal e familjar. Ata po harrojnë se për

kontributin e djeshëm, le të marrin mirënjohje e dekorata, mbase vetëm për këto kanë mbetur. Kombi dhe vendi kanë nevojë për njerëz që dinë të kontribuojnë për sot e nesër. Sot pakkush është duke e mbrojtur luftëtarin liridashës dhe historinë e lavdishme të UÇK-së, por edhe më keq, ata janë duke e dëmtuar edhe ardhmërinë e vendit dhe të kombit. Ata po nëpërkëmbin çdo vlerë kombëtare, të djeshme a të sotshme. Njerëzit tanë që sot e përbëjnë shumicën dhe njëkohësisht perspektivën e kombit, janë 20-25 vjeçarët, ata të cilët vetëm kanë dëgjuar për luftën, por e sotmja, perspektiva që po e prekin për ditë, nuk po i lejon ata që ta shohin luftën si vlerë. Ata po dëgjojnë edhe tregime të tjera! Gjuha juaj e paartikular me shqipen letrare, kultura e komunikimit në institucionet e shtetit, në institucionet e arsimit të lartë, të mesëm e filior, në administratë e medie, nuk jeni duke ua mbushur mendjen se këtu ka zhvillim,

siguri për punë e përparim. Sa për vlerën e nëpërkëmbur nga vetë krijuesit e saj as mos të flasim. Ajo jo vetëm ka shpërthyer turpshëm, por edhe me arrogancë në ditët e fundit. Gjeneratën e re nuk po e lejoni ta shohë perspektivën, ju rrahgjoksit e luftës që rinia jonë, djemtë e vajzat e mrekulueshme, ta shohë perspektivën në Republikën e Kosovës! Kjo është tepër e dhimbshme! Besimin rinisë nuk mund t'ia kthejnë ata që ia humbën çdo shpresë! Vetëm ata që dinë e duan dhe kanë dashuri për shtetin e kombin, i kanë gjasat ta rikthejnë perspektivën e njerëzve tanë! Ekziston rreziku real, zhbërja e shtetit nga bërësit e lirisë! Kjo është e dhimbshme! E dhimbshme, shumë e dhimbshme! Xha Rapushi i Musarajt, i një kohe tjetër, po na përsëritet dhe jo vetëm në letërsi, por edhe në politikë e kudo tjetër! Do të ishte me fat çlirimi i njerëzve nga ky mentalitet rrënues i musketarëve.

Projekti 'Bashkimi i Qytetit' do t'i japë Ferizajt perspektivë të re

FERIZAJ, 19 SHTATOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, së bashku me kryeministrin Ramush Haradinaj dhe kryetarin e Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, kanë bërë të mërkurën hapjen e punimeve të projektit "Bashkimi i Qytetit" në Ferizaj, i cili kapë vlerën prej katër milionë dollarësh dhe përfshin ndërtimin e nënkalimit për automjete që do t'i lidhë rrugët "Vëllezërit Gërvalla" me "Latif Hasani", deri te rrethrotullimi afër Shtëpisë së Pensionistëve.

Në fjalën e tij para shumë qytetarëve ferizajas, kryeparlamentari Veseli ka thënë se është emocionuese kur kaq shumë qyte-

tarë marrin pjesë në ceremoninë e fillimit të një projekti, duke dëshmuar kështu nevojën e kahershme të tij. "E di që ky projekt ka qenë ëndërr për qytetarët e Ferizajt. Sigurisht ka pasur edhe skepticizëm. Por, ky projekt do të realizohet shumë shpejt, duke i dhënë qytetit të Ferizajt një dimension të ri, zhvillim dhe perspektivë, njëkohësisht do të krijojë siguri për nxënësit dhe të gjithë ferizajasit në përgjithësi", është shprehur Veseli.

Kreu i Kuvendit ka thënë se, sikurse qyteti i Ferizajt, po ndryshon e gjithë Kosova. Ai ka theksuar se Kosova po ecën vendosmërisht në rrugëtimin e saj



evropian. "Jemi të vetëdijshëm se ka ende shumë për të bërë dhe ende nuk po e arrijmë perspektivën të cilën të rinjtë tanë e duan. Thërras gjithë të rinjtë që të qëndrojnë në Kosovë dhe ta bëjmë bashkë ndryshimin. Vizioni ynë është shumë i qartë: integrimi euroatlantik dhe zhvil-

limi ekonomik", ka deklaruar Veseli, duke shtuar se ajo çfarë u duhet më së shumti qytetarëve është besimi. Me këtë rast, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se ndërtimi i këtij nënkalimi është projekti më i madh në 20 vjetët e fundit në Komunën e Ferizajt. Ai

ka bërë me dije se, përveç investimeve në projekte infrastrukturore, Ferizaj do të bëhet me spital regjional dhe së shpejti do të nisë projekti i ujëmbledhësit të Lepencit. Sipas Haradinajt, Qeveria po dëshmon se është hallkë që lidhë dhe bashkon vendin me projekte moderne.

Raporti i DASH për terrorizimin: Korrupsioni pengoi zbatimin e ligjit

Departamenti amerikan i Shtetit publikoi të mërkurën raportin vjetor për terrorizmin në botë për vitin 2017. Vijnë një përmbledhje e pjesëve për Shqipërinë dhe Kosovën.

Në raport thuhet se gjatë vitit 2017 Shqipëria ishte një mbështetëse e fuqishme e përpjekjeve kundër terrorizmit dhe vazhdoi pjesëmarrjen e saj në Aleancën Globale për të Mposhtur ISIS-in.

Shqipëria, thuhet në raport, penalizon veprimet terroriste, financimin e terrorizmit, kryerjen e transaksioneve me persona që janë në listat e sanksioneve të Kombeve të Bashkuara, rekrutimin dhe trajnimin e njerëzve për kryerjen e veprave terroriste, nxitjen e akteve terroriste dhe krijimin apo pjesëmarrjen në organizata terroriste.

Gjatë vitit 2017, thuhet në raport, Forcat e Rendit në Shqipëri i shtuan përpjekjet për të luftuar kërcënimet e mundshme terroriste.

Korrupsioni dhe pengesat ndaj shkëmbimit dhe informacionit midis agjensive qeveritare, koordinimi i pamjaftueshëm brenda agjencive dhe një sistem gjyqësor që funksionon dobët,

thotë raporti, vazhdoi të pengonte përpjekjet e zbatimit të ligjit në të gjitha nivelet.

Në raport thuhet gjithashtu se në vend po bëhen reforma kushtetuese dhe ligjore për gjyqësorin, duke filluar me verifikimin e 800 gjyqtarëve dhe prokurorëve për korrupsion apo lidhje me krimin e organizuar si dhe për aftësitë e tyre profesionale.

Kosova

Kosova vazhdoi t'i kundërvihet kërcënimit gjithnjë në rritje të terrorizmit në vitin 2017, thuhet në raport.

Rreth 403 qytetarë të Kosovës, thotë raporti, kanë udhëtuar në Siri dhe Irak për t'u bashkuar me ISIS-in apo Frontin el-Nusrah, prej të cilëve rreth 74 kanë vdekur. Rreth 133 prej këtyre individëve janë kthyer, ndërsa rreth 196 mbeten në këto zona konfliktit. Ky numër përfshin 40 fëmijë të lindur nga qytetarë të Kosovës në zonat e konfliktit.

Gjendja e sigurisë dhe ajo politike në veriun e Kosovës, thuhet në raport, ka vazhduar të kufizojë aftësinë e qeverisë për të ushtruar autoritetin e saj në atë rajon, megjithëse qeveria ka



integruar me sukses gjyqtarët, prokurorët dhe stafin serb në institucionet gjyqësore të Kosovës në tetor, duke zgjeruar autoritetin gjyqësor të vendit dhe qasjen në drejtësi për qytetarët.

Legjislacioni, zbatimi i ligjit dhe siguria kufitare: Kuadri ligjor i Kosovës është i mjaftueshëm për të ndjekur penalisht individë të dyshuar për kryerjen ose mbështetjen e aktiviteteve terroriste, por prokurorët nuk kanë

përvojë në raste të tilla, thuhet në raport.

Autoritetet e zbatimit të ligjit, thotë raporti, treguan aftësi të mjaftueshme për të zbuluar dhe parandaluar individë të ndryshëm që t'u bashkoheshin konflikteve në Siri dhe Irak.

Në Kosovë, thotë raporti, vazhduan gjykimet dhe hetimet për 51 të dyshuar dhe 29 raste, ku përfshiheshin disa imamë të arrestuar që nga viti 2014 nën akuza për terrorizëm. Në vitin

2017, autoritetet e Kosovës arrestuan pesë individë të tjerë nën të njëjtat akuzat. Autoritetet ngritën shtatë aktpadi të reja me akuza për terrorizëm që përfshinin 17 individë.

Gjatë vitit 2017, thuhet në raport, qeveria e Kosovës ndërmoi hapa aktivë për të përgatitur një strategji riatdhësimi për qytetarët e saj që ktheheshin nga zonat e konfliktit.

(gazeta-Shqip.com)

Revista 'Foreign Policy': Ndarja e Kosovës çon në katastrofë

Revista prestigjioze amerikane, "Foreign Policy" ka publikuar një analizë, në të cilën kundërshton idenë e ndarjes së Kosovës dhe këmbimit të territoreve me Serbinë. Autori Michael Rossi, profesor universitar shkruan se këshillat e këqija për këmbim territoresh dhe transferim të popullsisë nuk do të sjellin paqe. Sipas tij, më shumë ka gjasa të rikthehet gjakderdhja që e kishte pllakosur Ballkanin në vitet '90

"Ndarja është një mundësi e keqe dhe shumë e rrezikshme, dhe kjo ide prej shumë kohës ka qenë e refuzuar zyrtarisht nga të gjitha palët, për arsye të shumta", shkruan revista e njohur për shkrimet e saj rreth çështjeve të politikës ndërkombëtare.

"Çdo thirrje për të ri-kufizim kufijsh dhe për të shkëmbyer territorin pothuajse me siguri do të degjenerojë në llojin e dhunës dhe shkëmbimeve kaotike të popullsisë që rrënonte rajonin në vitet 1990", nënvizon "Foreign Policy" duke shtuar se kjo mund të sjellë luftëra në tokën evropiane.

Më tej media e njohur thekson

se ndarja do të shkatërronte vitet e punës nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqitë kryesore të Evropës Perëndimore që kanë dhënë imazhin e hartuar me kujdes të Kosovës për një shoqëri multietnike, si dhe përpjekjet për të bindur bashkësitë serbe dhe shqiptare për të jetuar së bashku.

"Marrëveshjet e mbështetura ndërkombëtarisht midis Beogradit dhe Prishtinës për krijimin e autorizimeve të autonomisë për serbët e Kosovës do të digjeshin".

Edhe autori i kësaj analize mendon se "kërcënimi që sjell korrigjimi i kufijve mund të hapë kutinë e Pandorës në rajon dhe kjo do t'i inkurajonte serbët në Bosnjë dhe shqiptarët në Maqedoni të kërkonin marrëveshje të ngjashme të shkëputjes territoriale dhe bashkimit me të afërmit e tyre etnik". Nëse kjo do të ndodhte, "Foreign Policy" thotë se bashkësia ndërkombëtare do të detyrohej të ndërhyjë në Ballkan për të ndaluar zhvillimet që do pasonin zinxhir.

(gazeta-Shqip.com)

Partition in Kosovo Will Lead to Disaster

Ill-advised land swaps and population transfers won't bring peace. They're more likely to revive the bloodshed that plagued the Balkans during the 1990s.

BY MICHAEL ROSSI | SEPTEMBER 19, 2018, 4:46 AM





MUHARREM MIFTARI

VARGJE QË DESHIFROJNË KODIN E TRINISË SË PËRSHPIRTSHME

*(Këndvështrim për librin
poetik "Në fillim ishte drita"
të poetit Sali Bashota)*

Emri i Sali Bashotës, si poet dhe e studiues, është bërë i njohur jo vetëm brenda botës shqiptare. Them kështu duke pasur parasysh se poezia e tij është përkthyer në shumë gjuhë të botës dhe është vlerësuar lart dhe mirëpritur mirë. Sali Bashota pa dyshim se është nga poetët më produktiv të sotëm. Ka të publikuar një mori veprash letrare (mbi tridhjetë sosh), por me këtë rast po ndalem te vëllimi poetik, më i veçanti dhe më emblematic, "Në fillim ishte drita", botuar në vitin që lamë.

Veçantia e këtij vëllimi, para së gjithash, konsiston në faktin se jo vetëm se në të trajtohet, fillim e fund, vetëm një temë, ajo e dashurisë, porse kjo temë trajtohet krejtësisht në mënyrë specifike, do të thosha origjinare.

Në poezitë e këtij vëllimi (të ndara në tre cikle: Si, Nëse, Kur), shpërfaqet bota e ndjeshme e subjektit lirik ndaj së dashurës, por edhe për dashurinë si koncept, përmes së cilës formësohet kuptimi i jetës.

Vetë titulli i vëllimit poetik "Në fillim ishte drita" sikur na asocionon diçka të tejetshme, tejbotshe, tejkohshme, diçka që i përket të shenjtërishmes. Kjo na përforcon bindjen tekta kujtojmë thënien biblike: ("Në fillim ishte fjala... Gjon").

Përkushtimin e tij ndaj dashurisë poeti na shpalos në vargjet e para, ku që në titull të poezisë së parë ai koncepton atë si "zjarr i shpirtit", ku "mijëra yje ia kanë zili...", për të vazhduar me po të njëjtin zell,

që dashuria ka formën e "qiellit të ndritur", por që, për ta formësuar profilin e saj "vetëm sytë... nuk mjaftojnë për portret".

Por subjekti lirik befasohet kur fryma e saj vjen si shtimung frymëzues nga qiejt, "si përfaqim yjesh" dhe shtron pyetje befasuese: "si zbritë nga qielli e hyre në poezi..".

Dhe i shtangur nga një fenomen i tillë i formësuar prej "flakës së fantazisë", subjekti lirik hamendësohet ndaj dhe shtron si dilemë: "Si ta pagëzojë këtë dashuri?" Ndërkaq, më në fund, poeti gjen enigmën e fjalës dashuri, sidomos kur ajo shfaqet "si uratë", prandaj subjekti lirik thotë: "Fjala jote bëhet dritë e përjetësisë".

Për dashurinë "zgjohen yjet" dhe, në një gjendje të tillë, "flet shpirti, flet dhe vetmia", se për poetin e dashura "nuk është vetëm dhembje", prandaj "fjala e poetit ndizet si dashuria/kur në horizont shfaqet e dashura". Për ta përballur harrimin, që të mos i ngajë atij, "qielli fton yjet për vallëzim", ku në "tangon e përkëdheljeve të gjata" habiten se si "...shpejt bleron kujtimi.../në mëngjes dhe kur bie nata...". Ndërkohë që, kur "ylli i mëngjesit kërkon mot tjetër" për dashurinë, "as vetëtimas as flaka nuk e djeg/imazhin e paharruar në perëndim të diellit".

Ndërkaq, subjektin lirik e mundon dilema e frikshme nëse pas dehjes vjen zemërimi dhe, nëse vërtet ndodh kjo, atëherë poeti na paralajmëron fundin e fatit të baladave, duke profetizuar se në cilën ditë do

të pësojnë ato: "Vërshimi i ujit të gjitha baladat i shemb/në ditën e nëntë të dashurisë", ndonëse për poetin koha nuk ka përkufizimin e zakonshëm, për të koha ngelet statike, sepse "sa herë dashuron/dielli nuk perëndon". Megjithatë, poeti i qaset dashurisë si një proces dialektit, se dashuria nuk është diçka metafizike, ndaj ai deklaron se "dashuria nuk e ka gjithmonë të njëjtin shkëlqim/si në çastin e lumtur, si në çastin e hidhur". Prandaj, për subjektin lirik, ndjenja e dashurisë nuk e ka koloritin e njëjtë, se mallin për të dashurën "diçka e tremb" dhe na duket se poeti arrin në pikën e vetëdijes, ndërsa ndien se "dallgët e shqetësimit i zgjon nostalgjinë", se nga malli për të dashurën bën që "një yll në qiell të këlthet".

Koncepti refleksiv mbi dashurinë

Poeti dashurinë e koncepton, veç të tjerash, edhe si fenomen, të cilit i qaset me një tonalitet refleksiv. Dashuria për subjektin lirik është komplekse si vetë jeta: "Jeta është si dashuria ime". Asgjë nuk mund ta deshifrojë filozofinë e heshtjes dhe vetmisë sa dashuria, duke i dhënë fjalës fuqinë e "dritës së përjetësisë".

Për subjektin lirik "dashuria është shtegtim/që rikthehet në shtratin e vet". Poeti shtron dilemën për rolin dhe funksionin e dashurisë te njeriu. Ai shtron dilemën se "sikur të ishte dashuria me dietë/do të humbte peshë kënaqësia" për të vijuar më tej se "sikur të ishte dashuria vetëm lutje/ndoshta të gjithë do të binin në gjunjë pa ngurrim".

Sipas poetit, aty "ku ka dhembje, ka dhe dashuri", se "asnjë zjarr nuk e ka flakërimin e

shenjtë/nëse dashuria hesht bashkë me shtrëngatën..".

Dashuria si hir i frymëzimit

Për dashurinë poeti ndien "pagjumësinë e fjalës", ndërsa sjell kujtimin për të dashurën dhe jo vetëm kaq, ajo në raste të veçanta shndërrohet "metaforë midis brigjeve të fantazisë" ndërsa ndiente nevojën e krijimit të "imazhit të dashurisë së parë". Por, kur ai injorohet "mbi supet e fjalës, ndjenjat protestojnë" dhe, në çaste vetmie, poeti ndien sikur "mjegulla e fjalës tretet" dhe, derisa "puthja e paftuar nuk vjen", poeti frikësohet se "mund të pëlçasë dhe vargu". Në këtë lloj përjetimi a ndjesie poeti sikur parandien se "enigmën e frymëzimit e valëvit era" dhe në çaste vetmie "mund të shkruhen poema të gjata", ndërkohë që bindet se më në fund, "kur dremit vargu i secilit poet/për dashurinë, gjithçka mund të thonë".

Struktura e ndërtimit të tekstit poetik

Sa i përket strukturës së ndërtimit të vargut e të strofës, poeti sikur i ka vënë vetes detyrë që idenë, mesazhin ta shpërfaqë përmes një strukture tradicionale, me strofa katërshe, me vargje standarde tetërokëshe, herë-herë duke e thyer atë.

Edhe për nga arsenali i figuracionit poetik, poeti Bashota ka përdorur një sërë figurash, si: metaforë, krahasim, epitet, simbol etj. përmes të cilave jo vetëm të shtyn të asocionosh, por duke u kujdesur edhe për tingujt, vargu i tij të nxitë ta lexosh edhe për muzikalitetin që krijon.

Pra vargu i poezisë rëndom

është i matur dhe i ngjeshur me rimë të alternuar, duke krijuar kështu ritmin që shkakton muzikalitetin e vargut.

Në vend të përfundimit

Derisa lexojmë vargjet e poezive të Bashotës, na ndër-mendësohen vargjet e Orfeut, tekta përshkruante gjëllimin e natyrës, tekta portretizonte figurën e së dashurës. Natyrë të ngjashme vërejmë edhe te Dionisi, te vëllimi "100 poezi për dashurinë".

Poeti Bashota nxjerr nga vargu i poetëve klasikë, sikundër janë Lasgushi dhe Agolli, frymën e këngëtimit mbi dashurinë jo vetëm si objekt trajtimi, por duke shtruar si koncept të meditim poetik.

Më në fund, poeti zbulon se dashuria, që të ndiesohet dhe të kuptimësohet, transformohet në frymëzim, në varg, në poezi, ndaj dhe deklamon solemnisht: "Ti je vetë poezia". Teksa e lexojmë fund e krye vëllimin "Në fillim ishte drita" që, sikundër e thamë që në fillim, na asocionon me thënien biblike "Në fillim ishte fjala", poeti Bashota ka dashur të na sjellë në mendje se, megjithatë, në brendi të fjalës është drita, që neve na vjen qoftë si mesazh, qoftë si frymëzim. Po kështu, ndërsa venerojmë ndërtimin e veprës, përmes tre cikleve: Si, Kur, Nëse... poeti Bashota, përmes sistemit të trinisë, që me këtë rast kujtojmë Hegelin me idenë e tij transcendentale të formës së kulluar, e cila arrihet duke kaluar prej vetvetes - jashtë vetvetes - për vetveten, mëton që, si idenë, mesazhin, ashtu edhe vargun, ta përçojë te lexuesi në mënyrë të kulluar.

(Marrë nga numri i katërt i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia")

MAQEDONIA E ALI AHMETIT NE NATO



Ismet SYLEJMANI

Maqedonia nën udhëheqjen e Ali Ahmetit shkelë të pashkelurën deri më tani në historinë e saj!

Maqedonia edhe de jure do të deklarohet para botës dhe para miqëve të shumtë, se është edhe shqiptare dhe me fuqi të madhe për stabilitet në rajon, Europe dhe botë!

Politikani modern shqiptar, patrioti e atdhetari i lavdishëm, luftetari e komandanti i përgjithshëm i UÇK-së, udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti, jo vetëm është njëri prej dirigjentëve fantastik dhe kyq të funksionimit të Maqedonisë si maqedono-shqiptare, por është edhe njeri prej aktorëve e faktorëve më të mëdhenj të stabilitetit e paqes, në rajon dhe më gjerë!

Ali Ahmeti, ky shqiptar i madh e i lavdishëm, që me politiken e tij të madhe dhe të hapur euroatlantike, ka dëshmuar dhe po dëshmon se është aleat i madh i paqes dhe stabilitetit jo vetëm në Maqedoni, në Ballkan dhe Europe por edhe më gjerë, me politiken e tij kombëtare në Maqedoni, po dëshmon se populli shqiptar ka rol vendimtarë e të padiskutueshem në funksionimin normal, progresiv e demokratik të Maqedonisë brenda dhe jashtë saj!

Maqedonia që pas lindjes së sajë, me Ali Ahmetin në udhëheqje, për herë të parë ka marrë pamjen e saj reale dhe të vërtetë, sepse duke e pasur popullin shqiptar njërin prej themeluesve të saj, ajo po del me referendumin për tu anëtarësuar në NATO dhe në BE, i cili jo vetëm do të jetë i suksesshëm por edhe i projektuar të jetë i tillë!

Populli shqiptar në Maqedoni nën udhëheqjen e birit dhe udhëheqësit të saj Ali Ahmeti, duke votuar ne referendumin për hyrjen në NATO dhe BE, jo vetëm përbushë kërkesën e madhe dhe largëpamëse për brezat shqiptare që do të vijnë, por dëshmon edhe njëherë përpara botës, se ishte i shtypur padrejtësisht në ish-Maqedoninë jugosllave, se është popull i madh dhe heroik, pasi mposhti të gjitha të kqiat që i ranë mbi supë, dhe tash fitimtarë si kurrë më parë, radhitet përkrah popujve që janë zot të fateve të veta në shtetet e tyre!

Maqedonia në NATO dhe në BE është fitore e madhe jo vetem e udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, por edhe të gjitha atyre figurave dhe personaliteteve të



mëdha shqiptare në këtë shtet, të cilat me vite dhe dekada, bënë që populli shqiptar ta ruajë fuqinë e tij përballë politikës shfarosëse dhe zhdukëse të xhelatit e kriminelit Rankoviq dhe pasardhësit të tij, kryexhelatit të Ballkanit Milosheviq!

Vota pro Maqedonisë në NATO dhe BE nderon popullin shqiptar, nderon gjakun e derdhur për liri, nderon të plagosurit e lirisë, nderon luftëtarët dhe komandantët e UÇK-së, nderon barazinë

gjuhësore, nderon flamurin, nderon dy universitetet shqiptare, nderon policinë shqiptare, nderon ushtrinë shqiptare dhe nderon administratën shqiptare!

Vota pro Maqedonisë në NATO dhe BE, është votë për aleatet e mëdhenj të popullit shqiptar SHBA, Angli, Gjermani, Itali, France dhe aleat të tjerë!

Vota pro Maqedonisë në NATO dhe BE, është votë kundër errësirës dhe vuajtjeve të popullit shqiptar jo vetëm në Maqedoni

dhe më gjerë!

Maqedonia në NATO dhe BE, për popullin shqiptar është fitore e madhe dhe perspektivë e sigurtë me të ardhme e cila garanton paqe dhe stabilitet në të gjitha fushat!

Maqedonia në NATO dhe BE është fitore e madhe për popullin shqiptar dhe udhëheqësin e saj Ali Ahmeti!

Maqedonia në këto dy institucione të mëdha kontinentale dhe botërore, është fitore epokale shqiptare!

Fitoret e popullit shqiptar gjithmonë i kanë sjellur të mira të mëdha të gjithë miqëve dhe aleatëve të tijë kudo nëpër botë!

Edhe fitorja e referendimit të hyrjes së Maqedonisë në NATO dhe BE që është e sigurtë, vetëm të mira dhe vetëm perspektivë i sjell popullit shqiptar, i cili ka vuajtur shumë në të kaluarën nga pushtues dhe rregjime të ndryshme!

Prishtinë, 19 shtator 2018!




E jashtëzakonshme

Gjendet pas 250 vjetësh anija legjendare e kapitenit James Cook

Anija legjendare e kapitenit James Cook, HMS Endeavor, besohet të jetë gjetur më në fund pas 250 vjetësh. Arkeologët detarë, të cilët kanë kaluar më shumë se dy

dekada në kërkim të anijes, thonë se tani kanë identifikuar pikën e saktë ku po 'pushon' HMS Endeavor. Detajet e asaj që do të zgjidhë një nga misteret



më të mëdha detare të të gjitha kohëve do të shpallen zyrtarisht të premtën në Shtetet e Bashkuara.

FOTO E DITES



Një grua pozon jashtë shpellës akull në Rhone Glacier në Furka, Zvicër. Fotoja është publikuar te 'Zëri i Amerikës'.

E rrallë

Afrika e Jugut legalizon përdorimin e marijuanës

Gjykata më e lartë në Afrikën Jugore ka legalizuar përdorimin e kanabisit për të rriturit në vende private. Aktivistët pro marijuanës kanë festuar në publik, duke bërë titur "Marijuanë, je e lirë tani", pasi Gjykata Kushtetuese ka marrë vendimin. Në një vendim unanimit gjyqtarët



kanë legalizuar edhe rritjen e bimëve të kanabisit për konsumim në ambiente private.

BARSOLETA E DITËS



I dashuri: Do të dalësh për kafe me mua?

E dashura: Nuk dua kafe. Dua "Red bull".

I dashuri: Më mirë dalim një ditë tjetër.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

Rolet: Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

Regjia: Genndy Tartakovsky



Në ora 18:00

"THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

Rolet: Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

Regjia: Jennifer Yuh Nelson



Në ora 20:00 dhe 22:00

"THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

Rolet: Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilara, Jake Busey, etj.

Regjia: Shane Black



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Edhe pse duket sikur po shpenzoni shumë këto kohë nuk është e vërtetë. Po merrni thjesht ato gjëra që i keni shumë të nevojshme.



DEMI

Sot edhe pse duhet të rri shumë kohë në punë, mos u shqetësoni. Është mirë të rikuperoni në kohë sepse do t'ju nevojitet.



BINJAKËT

Sot do të keni një dyluftim ndjenjash midis miqve tuaj dhe partnerit. Do t'ju vënë përballë një zgjedhjeje të vështirë.



GAFORRJA

Edhe pse në përgjithësi jeni shumë egoist sot do t'ju duhet t'i bëni ju zgjedhjet për familjen tuaj. Jeni në pozitë të vështirë.



LUANI

Dita e sotme është mjaft me fat për të lindurit e kësaj shenje. Çdo gjë do të shkojë më mirë sesa që e keni menduar.



VIRGJËRESHA

Një ngërc sot do të bëjë të ndryshoni gjithë programin e ditës. Pa zgjidhur këtë problem nuk mund të ndërmerrni asnjë veprim.



PESHORJA

Sot do të jeni mjaft të drejtë lidhur me këshillat që do t'ju kërkohen. Mund të pozicionoheni vetëm në ato raste që mendoni se është zgjidhja më e mirë.



AKREPI

Keni kohë që keni filluar aktivitetet fizike dhe ndjeni që kjo gjë i bën shumë mirë shëndetit tuaj.



SHIGJETARI

Kjo ditë do t'ju ofrojë emocione të forta dhe do të ndiheni të përkëdhelurit e fatit.



BRICJAPI

Sot dita paraqitet e qetë dhe ju do të doni ta shijoni në çdo moment. Një surprizë e bukur në horizont.



UJORI

Edhe pse doni të niseni në një udhëtim, e keni agjendën shumë të zënë këtë kohë. Mjaft aktivitete duan patjetër bashkëpunimin tuaj.



PESHQIT

Edhe pse sot jeni impulsiv, në çaste të caktuara do të ndaloni dhe do të mendoni mirë atë se çfarë do të bëni.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Shijo Pranverën me...

Jaffa Champion PLUS A+C+E Multifrutti

Taste of World Wide Brand!

2L

Jaffa Champion

Kim dhe Kanye zhvendosen nga Los Angeles



Kanye West ka bërë një paraqitje në një ngjarje në Çikago, Illinois, ku edhe bëri publik një lajm. "Dua që ju të gjithë ta dini se po kthehem në Çikago dhe nuk do të largohem kurrë më", ka thënë Kanye, shkruan "TMZ". Reperi

është duke u larguar nga Los Angeles ku jeton me gruan Kim Kardashian dhe tre fëmijët. "TMZ" raporton se Kimi dhe Kanye kanë gjetur një vend në Çikago dhe planifikojnë të kenë një qëndrim të përhershëm atje.

Lindsay Shookus rikthehet në "Instagram"



Lindsay Shookus është rikthyer në rrjetin social "Instagram" pasi pushoi pak nga ky rrjet social për disa javë dhe tani ka diçka për të festuar. Regjisorja fituese ka shtuar edhe një çmim Emmy në koleksionin e vet të hënën. Lindsay

u bashkua me bashkëpunëtorët në skenë për ta pranuar çmimin ku edhe bëri fotografi, të cilën e postoi në "Instagrami". Muajin e kaluar Lindsay dhe i dashuri i saj Ben Affleck u ndanë pas një viti në lidhje.



Katie Holmes dhe Jamie Foxx s'ndahen nga njëri-tjetri

Katie Holmes dhe Jamie Foxx janë parë bashkë në publik. Aktorja 39-vjeçare dhe aktori 50-vjeçar u panë teksa ndaluan afër një palestere të hënën në Atlanta. Katie udhëtoi drejt Gjeorgjisë për të qenë sa më afër

të dashurit pasi ai është duke punuar për filmin e ri 'Just Mercy'. Ajo është fotografuar në çastin e arritjes duke dalë nga një avion privat. Çifti është në lidhje tash e disa vjet, por e ka mbajtur marrëdhënien jashtëzakonisht private.

The Weeknd përfundon në gjyq

The Weeknd dhe bashkëpunëtorët e tij Daft Punk po paditën për këngën 'Starboy' nga një kompozitore tjetër e cila pretendon se e vodhën. Kompozitorja Yasminah ka ngrehur padi kundrejt tij duke e akuzuar se i ka vjedhur ritmin dhe melodinë e këngës së kënduar gjatë vitit 2009. Sipas mediave të huaja, ajo kërkon dëmshpërblim pesë milionë dollarë



dhe mbështetësit e saj thonë se ka të drejtë, pasi të dyja këngët janë tepër të ngjashme.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

GALATASARAY - LOKOMOTIV MOSCOW

1

SCHALKE 04 - FC PORTO

GG

LIVERPOOL - PSG

1

Sokoli - Llapi, e ardhmja në 'mjegull'

Drejtuesit e Llapit ende nuk kanë marrë vendim përfundimtar rreth së ardhmes së trajnerit Bylbyl Sokoli, i cili ka ofruar dorëheqje pas mosmarrëveshjeve me futbollistët. "Kryesia ka pasur një takim me futbollistët, por asnjë vendim nuk është marrë. Sokoli ende është pjesë e klubit", ka thënë Tahir Batatina, drejtor i Llapit



zyrtar nuk është marrë deri të mërkurën pasdite.

Drejtori Tahir Batatina për "Epokën e re" ka konfirmuar takimin në mes të kryesisë dhe futbollistëve por, sipas tij, ende nuk ka asgjë zyrtare me largimin

e Sokolit nga klubi. "Kryesia ka pasur një takim me futbollistët, por asnjë vendim nuk është marrë. Sokoli ende është pjesë e klubit", ka thënë Batatina.

I pyetur se kur do të merret vendimi lidhur me të ardhmen e tra-

nerit, Batatina ka deklaruar: "Tash për tash asnjë vendim zyrtar nuk ka. Kryesia ende nuk ka vendosur asgjë, por do të vendosë së shpejti". Gazeta ka mësuar se problemi në mes të trajnerit Sokoli dhe futbollistëve ka ardhur pas kritikave të vazhdueshme që i ka bërë Sokoli në drejtim të tyre, edhe kur skuadra arrinte fitore. Trajneri Bylbyl Sokoli javën e kaluar për "Epokën e re" deklaroi se skuadra e Llapit synim kryesor nuk e ka titullin, por zhvillimin e ndeshjeve të mira. "Titulli nuk synohet me çdo kusht, por lojtarët e mira. Lojtarët po japin maksimumin dhe besoj shumë se së shpejti do të vijmë te loja që e dëshirojmë", kishte deklaruar "Profa", i cili konsiderohet ndër trajnerët më të mirë në vend.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 SHTATOR - Trajneri Bylbyl Sokoli nuk po arrin të "rehatohet" në skuadrën e Llapit. "Profa", pasi ka marrë drejtimin e kësaj skuadre, pati mosmarrëveshje me drejtuesit e klubit për mënyrën e funksionimit, por ato mosmarrëveshje u tejkaluan dhe ai vazh-

doi të drejtojë këtë skuadër që synim kryesor e ka titullin e kampiones.

Të mërkurën doli në sipërfaqe një tjetër "sherr" në këtë skuadër, ku futbollistët nuk pranuan të stërviten nën drejtimin e Sokolit dhe kërkuan nga drejtuesit e klubit ta largojnë. Gazeta ka mësuar se kryesia e klubit ka pasur një takim me futbollistët, por asnjë vendim

50 mijë euro për stadiumin e Hanit të Elezit

"Këto marrëveshje kanë për qëllim investimet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Hanit të Elezit si përkushtim i Ministrisë për të investuar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të kësaj jemi jashtëzakonisht të interesuar që edhe komunat e vogla që kanë buxhet të vogël t'i ndihmojmë në mënyrë që edhe të rinjtë dhe komuniteti artistik të përfitojnë prej këtyre investimeve", ka thënë ministri Gashi



PRISHTINË, 20 SHTATOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar Komunën e Hanit të Elezit dhe Komunën e Kaçanikut. Gjatë kësaj vizite u nënshkruan dy memorandume bashkëpunimi, njëri prej tyre për rregullimin e stadiumit. Sipas memorandumit për Rregullimin e Stadiumit, MKRS-ja dhe Komuna do të investojnë financiarisht nga 50 mijë euro, investim i cili do të kryhet gjatë vitit 2019. "Këto marrëveshje kanë për qëllim investimet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Hanit të Elezit, si përkushtim i

Ministrisë për të investuar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të kësaj jemi jashtëzakonisht të interesuar që edhe komunat e vogla që kanë buxhet të vogël t'i ndihmojmë në mënyrë që edhe të rinjtë dhe komuniteti artistik të përfitojnë prej këtyre investimeve", ka thënë ministri Gashi, i cili ka folur edhe për dyshekët e dhuruar nga Ministria për klubet e sportit të mundjes. Sipas tij, dhurimi i pajisjeve apo i dyshekëve për sportin e mundjes bëhet me qëllim që të gjithë sportistëve t'u krijohet kushte më të mira që të kenë edhe hapësira dhe pajisje

ku t'i organizojnë ushtrimet e tyre. "Besoj se jemi duke bërë një punë të mirë në mbështetje të komunave dhe të gjitha kërkesave që na vijnë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit", ka shtuar ai.

Ndërsa kryetari Suma falënderoi ministrin për vizitën, por edhe për nënshkrimin e marrëveshjeve për realizimin e projekteve që janë në interes të komunës.

Palestra në Kaçanik përfundon në vitin 2019

Ministri Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, po të

mërkurën e vizitoi edhe Komunën e Kaçanikut. Gjatë kësaj vizite ministri u prit nga kryetari i Komunës, Besim Ilazi. Ministri Gashi dhe kryetari Ilazi inspektuan punimet në palestrën e sportit të qytetit. Gjatë inspektimeve të punimeve ministri ka deklaruar se kjo palestër është investim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. "Qëllimi i kësaj vizite është inspektimi nga afër i punimeve, në të njëjtën kohë për të kërkuar edhe nga operatori ekonomik, nga kompania e cila po realizon punimet në këtë projekt, t'i shtojë punimet në

mënyrë që këtë palestër sportive, këtë objekt gjigant që e investon MKRS-ja, ta kemi të gatshme në fillim të vitit 2019", ka thënë Gashi. "Ky bashkëpunim mes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Kaçanikut do të vazhdojë edhe më tutje. Jemi bashkërisht këtu për ta konfirmuar bashkëpunimin, në të njëjtën kohë edhe për të kërkuar që ky projekt të përmbillet në një afat sa më të shpejtë", theksoi ministri Gashi.

Ndërsa kryetari Ilazi ka deklaruar: "Patëm kënaqësinë ta kemi për vizitë ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë inspektimi i punimeve në palestrën sportive, një projekt i filluar mjaft herët, por që s'ka arritur të përfundohet". Punimet në këtë palestër, kryetari i komunës i vlerësoi si një projekt i harruar, andaj falënderoi ministrin për vizitën dhe për kujdesin e tij, duke thënë se vizita dhe kujdesi i ministrit kanë ndikuar në shtimin e dinamikës të punës.

Prishtina pret Donar Groningenin në Ligën e Kampionëve

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Skuadra e Z Mobile Prishtinës është nikoqire e Donar Groningenit nga Holanda në kuadër të raundit të parë të kualifikimeve për Ligën e Kampionëve në basketboll. Ndeshja do të zhvillohet sonte (e enjten) në palestrën e vogël

të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë nga ora 20:30.

Për basketbollistët "bardhekaltër" kjo është një sfidë shumë e rëndësishme para ndeshjes së kthimit që do të luhet dy ditë më vonë në Groningen. Megjithatë, me

përkrahjen e tifozëve të cilët priten të jenë në numër sa më të madh të enjten në Prishtinë, skuadra nga kryeqyteti shpreson të triumfojë dhe kështu të krijojë avantazh para duelit të kthimit në Holandë.

Donar Groningen është kam-

pion në Holandë, kurse në edicionin e kaluar ka qenë pjesë e Final Four të FIBA Evropë Kupë. Ndërsa Z Mobile Prishtina është fituese e Kupës së Kosovës për edicionin e kaluar, kurse ditë më parë është stolisur edhe me trofeun e Superkupës së Kosovës.



Hamiltoni: Botërori ka edhe gjashtë gara

LONDËR, 20 SHTATOR - Lewis Hamiltoni ka 40 pikë avantazh karshi Sebastian Vettelit në renditjen e përgjithshme të Formula 1, por piloti britanik shprehet se asgjë nuk është e mbyllur për sa i përket titullit kampion. "Nuk kam asnjë plan për garat e radhës se si

të shpallim kampion, pasi ky është një sport ku dështimi mund të vijë edhe nga një defekt i vogël i makinës. Unë përpiqem t'i marr garat një e nga një, t'i fitoj të gjitha dhe në këtë mënyrë të shpallim kampion. Punoj dhe i përgatis garat ashtu si gjithnjë dhe nuk

kam ndërmend ta ndryshoj stilin", ka thënë Hamilton. "Humbja që pësua në Spa na vuri në lëvizje dhe pas atij zhgënjimi erdhën dy fitore, në Itali dhe Singapor. Punojmë fort që të premten e deri para garës për të pasur një makinë të shpejtë, të

besueshme dhe fituese, duke u përpjekur të marrim 102 % nga makina", ka deklaruar Hamiltoni. Më tej, britaniku ka shtuar: "Të kesh 40 pikë avantazh është pozitive, por ka ende edhe gjashtë gara deri në fund. Ne punojmë më të qetë, por nuk heqim dorë nga



mundësia për ta përmirësuar edhe më tej makinën, pasi çdo garë kërkon një qasje ndryshe".

Kuka, pas shortit: Çdo plasman në tetë të parët do të jetë sukses i madh

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Është hedhur shorti për Kampionatin Botëror të Xhudos "Baku 2018", i cili do të mbahet në Baku të Azerbajxhanit, nga e premja deri më 27 shtator. Kosova përfaqësohet me katër garues: Akil Gjakova (-73 kilogramë), Distria Krasniqi (-48 kilogramë), Nora Gjakova (-57 kilogramë) dhe Loriana Kuka (-78 kilogramë). Majlinda Kelmendi pushon për shkak të rikuperimit të lëndimit. Është kjo gara më e fortë dhe më e rëndësishmja e xhudos për vitin 2018. Bazuar në short, Distria Krasniqi ishte e pafat, pasi në raundin e dytë do të përballet me ukrainasën Daria Bilodid, e cila po dominon në kategorinë -48 kg. Bilodid e mposhti herën e kaluar Krasniqin në Grand Slamin e Zagrebit, duke fituar më pas medaljen e artë. Në rrethin e parë Distria takohet me Jacqueline Solis të Guatemalës. Kampionia e Evropës, Nora Gjakova, raundin e parë e kalon pa luftë, ndërsa më pas pret fituesen e çiftit: Soumiya Iraoui (Maroko) - Abzetta Dabonne (Bregu i Fildishtë). Edhe Loriana Kuka raundin e parë e kalon pa luftë, ndërsa në të dytën takohet me slovenen e njohur për të,



Klara Apotekar, të cilën e kishte mposhtur në Evropianin "Tel Aviv 2018". Ndërkaq Akil Gjakova që po kalon formë të mirë, misionin e tij në botëror e nis nga raundi i dytë, ku për kundërshtar ka Magner Mendes të Bregut të Fildishtë.

Përzgjedhësi i Kosovës, Driton Kuka, ka thënë se gara është jashtëzakonisht e fortë. "Çdo plasman në tetë të parët do të jetë sukses i madh, e medalja do të ishte sukses i jashtëzakonshëm", ka thënë Kuka për sajtin zyrtar të Komitetit Olimpik të Kosovës.

"Shorti është goxha i vështirë, s'dua të flas në detaje, por realisht në grupe secili ka garues të fortë dhe të papërshtatshëm. Distria starton kundër garueses që sivjet është larg më e mira në 48 kg, që është duke dominuar në botë në këtë kategori, ukrainasja Bilodid por, të shohim. Edhe ne jemi përgatitur për këtë garuese. Nëse strategjia jonë do të jetë e suksesshme, kemi gjasa", ka shtuar Kuka. Distria garon nesër (e premte), kurse të shtunën Akil dhe Nora Gjakova. Loriana do të dalë në tatami të martën.

Ledri Vula, nënkryetar i Z Mobile Prishtina

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Reperi i njohur Ledri Vula është emëruar nënkryetar i Z Mobile Prishtina. Presidenti i klubit kryeqytetas, Blerand Stavileci, ka prezantuar Vulën në një konferencë për medie, duke thënë se kanë pasur dëshirë që sivjet t'i mbledhin afër klubit edhe njerëz të suksesshëm të njohur në fusha të tjera që lidhen me basketbollin. "Për neve si klub që po rritemi është kënaqësi që një djalë i suksesshëm si Ledri t'i bashkohet një njëshi tjetër, siç është Z Mobile Prishtina. Nesër e kemi ndeshjen më të rëndësishme të sezonit dhe po mundohemi që në aspektin organizativ të jemi në nivelin më të lartë. Ka me qenë spektakël edhe jashtë parketit, sepse kemi forcuar ekipin", ka thënë Stavileci. Ndërsa Ledri Vula është shprehur



i lumtur për detyrën e re, kurse i ka ftuar të rinjtë të merren më shumë me basketboll. "Faleminderit Blerand për idenë! Prej kur më ke tregu për të ardhmen, 100 për qind kam qenë për. Tash, fatmirësisht, po kemi salla, përpara s'kemi pasur. Kisha pasur dëshirë që rinia të gjejë kohë për t'ia kushtu-

ar topit, për shëndetin është e mirë, por edhe për shtetin. Do të jem këtu dhe të investoj në të ardhmen e basketbollit. Ëndërr kam pasur të luaj një lojë, të paktën në Ligë të Parë, por kam vazhduar të merrem me muzikë. Më ka marrë malli për erën e sallës së 'Boro Ramizit', ka thënë Vula.

SHKURT

Shaqiri: Fitorja dhe atmosfera ishin të mrekullueshme në 'Anfield'

Mesfushori me origjinë shqiptare, Xherdan Shaqiri, ka debutuar në Ligën e Kampionëve me fanellën e Liverpoolit, kurse "Reds" ka shënuar fitore ndaj PSG-së (3-2). "Ishte e mrekullueshme. Gjithmonë është kështu kur shënohet goli i fitores para tifozëve të cilët ishin të mrekullueshëm. Ata na mbështetën deri në fund. Ishte një fitore e mrekullueshme për të gjithë", ka thënë Shaqiri. "Unë e ndjeva këtë gjatë ndeshjes se sa të zhurmshëm janë tifozët. Ishte një ndeshje e mirë për ta shikuar dhe në luajtëm mirë për plot 90 minuta. Ne e dinim se PSG-ja është skuadër e mirë. Nuk mund të bënim gabime të vogla sepse PSG-ja është një ndër skuadrat më të mira dhe do ta shfrytëzonte çdo gabim tonin. Ajo shënoi golin e barazimit", ka deklaruar Shaqiri. "Por, ne tentuam deri në fund dhe e merituar të fitojmë sepse nëse do të kishim barazuar, do të ndiheshim shumë të mërzhitur. E merituar të fitojmë për performancën e mrekullueshme që bëmë". Shaqiri ende nuk e ka nisur asnjë ndeshje që nga fillimi i sezonit të ri për Liverpoolin, ku u transferua gjatë afatit kalimtar të verës. Megjithatë, ai është i bindur se është i nevojshëm për skuadrën. "Skuadrës i nevojiten të gjithë lojtarët. Për të qenë të suksesshëm gjatë një sezoni, çdo lojtar është i vlefshëm. Do të kemi shumë ndeshje të vështira, kështu që të gjithë duhet të jemi të gatshëm", është shprehur Shaqiri. "Kemi një skuadër shumë të mirë dhe të gjithë mund të luajnë. Çdo lojtar do të jetë i rëndësishëm gjatë sezonit".

Tony Blair mund të bëhet president i Premierë Ligës

Ish-kryeministri anglez, Tony Blair, është shpallur si presidenti potencial i ardhshëm i Premierë Ligës, raporton "Daily Mail". Ai e mbajti detyrën e lartë ekzekutive në Angli për 10 vjet dhe, ndërkohë, këmbënguli se ishte një mbështetës i Newcastle's. Tony Blair kishte një ndjenjë se futbollit nuk ishte kurrë pasioni i tij, duke e bërë atë një kandidat të pazakontë për pozicionin e drejtuesit të Premierë Ligës. Sidoqoftë, janë vetë klubet ato që e konsiderojnë Tony Blairin si presidentin e radhës të Premierë Liga. Ai u largua nga zyra në vitin 2007 dhe pas 10 vjetësh si kryeministër, sigurisht se ka mjaft karizëm dhe autoritet natyral për ta mbajtur rendin midis 20 klubeve të elitës së futbollit anglez. Emrat e tjerë që qarkullojnë për këtë pozicion ekzekutiv janë ish-shëfi i BT, Gavin Patterson, dhe shëfi i sportit në "Sky", Barney Francis.

Messi, lojtari me më shumë tregolështa në historinë e LK-së

Leo Messi vazhdon t'i shtojë rekordet e karrierës së tij të mrekullueshme sportive. Rekordi më i ri i yllit argjentinas është ai i tregolështave. Me tri perlat ndaj PSV-së, Messi është tashmë futbollisti me më shumë tregolështa në historinë e Ligës së Kampionëve, plot 8 (kundër PSV, City, Celtic, Apoel, Ajax, Leverkusen, Plzen, Arsenal). Lojtari i Barcelonës ka një tregolësh më shumë sesa Cristiano Ronaldo. Performanca e Messit në Ligën e Kampionëve na sjell në kujtesë se argjentinas nuk është në listën e FIFA-s për "The Best", ku janë përfshirë Modriqi, Cristiano Ronaldo dhe Salah.

Negredo transferohet tek Al Nasri

Alvaro Negredo është transferuar në Al Nasr në Emiratet e Bashkuara Arabe. 33-vjeçari ka vendosur të largohet nga futbollit evropian duke filluar një aventurë të re. Ai kaloi edicionin e shkuar të Beshiktashi në Turqi, por tani ka gjetur një klub të ri. Negredo ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me Al Nasrin, ku do të bashkohet me ish-mesfushorin e Newcastle's dhe Paris Saint-Germainit, Yohan Cabaye.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Brigada 125"
Komuna: Prizren
Data: 20. Shtator 2018
Emri i kontratës: Organizimi i ekspozitës me krijimet e nxënësve për
Numri i kontratës: ESIP/C.1.3/083 - ESIP/SDG/083-CS /1.1

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Brigada 125", Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

- Organizimi i ekspozitës në objektin e shkollës, ku nxënësit do të shpalosin punën e tyre artistike.

Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik dhe termeve të referencës në adresën e Shkollës "Brigada 125", Prizren më së largu deri më **01. Tetor 2018**.

Specifikimi i hollësishëm teknik dhe termet e referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-shërbime do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Kontakti: Ryvije Shijaku
Telefoni: 045510037
E-maili: sh.f.brigada125@hotmail.com

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Haliti Beton" Sh.p.k. Mushtisht, Suharekë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin e prodhimit të betonit në Mushtisht, komuna e Suharekës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.10. 2018. në ora 11:00 në hapësirat e administratës të kompanisë "Haliti Beton" në Mushtisht komuna e Suharekës do të organizohet debat publik nga kompania "Haliti Beton" Sh.p.k. Mushtisht, Suharekë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin e prodhimit të betonit në Mushtisht, komuna e Suharekës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Visar Krasniqi"-Drenoc
Komuna: Malishevë
Data: 20.09.2018

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/057- ESIP/SDG/057-CS/1.3	Vizita me karakter mësimor në Kosovë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Visar Krasniqi"- Drenoc, Malishevë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimit të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

- ☐ Vizita me karakter mësimor në Kosovë

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën e shkollës "Visar Krasniqi"- Drenoc-Malishevë. më së largu deri më **28.09. 2018**.

4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentët luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Bukurije Imeraj Krasniqi
Telefoni: 044 168 117
E-maili: Lija_70@postrib.com

Njoftimi për shprehje të interesit

Shf.mu "Osman Mani" Firajë Komuna Shtërpçë
Data: 20.09.2018

Emri i kontratës: Vlerësimi përmbledhës
Numri i kontratës: ESIP/C1.3/103- ESIP/SDG/103-CS/1.2

